



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor në Histori”

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Rudina MITA

Dr. Ejona ISUFAJ

Maj / 2023

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 1

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bachelor në "Histori"

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Historisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor. në "Histori"
4	Urdhri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 359, datë 21.09.1991 *
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës	-
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit	15 PAE / 9 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 94 studentë; 2020-2021 47 studentë; 2021-2022 49 studentë;

**Emërtimi sipas kësaj VKM, është: dega histori-geografi me dy profile: profili me specialitet të parë historinë e të dytë gjeografinë dhe profili me specialitet të parë gjeografinë e të dytë historinë.*

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.207 dt.30.05.1957. UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 4, datë 27.01.2023, me kohëzgjatje 6 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.01.2029. Universiteti i Tiranës sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute emërtuar si vijon:

- Filiali i Sarandës
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Drejtësisë
- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Instituti i Fizikës Bërthamore
- Instituti i Studimeve Evropiane

Statuti i UT, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” është miratuar në vitin 2018.

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Histori” është hapur me VKM Nr. 359, datë 21.09.1991, ku sipas kësaj VKM, emërtimi është: dega histori-gjeografi me dy profile: profili me specialitet të parë historinë e të dytë gjeografinë dhe profili me specialitet të parë gjeografinë e të dytë historinë. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare Bachelor në "Histori".

Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Historisë, njësi përbërëse e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë. Programi i studimit Bachelor në "Histori" ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit European të transferimit të krediteve në 180 kredite ECTS. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT.

UT ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Histori” më datë 26.10.2021. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin për herë të parë të këtij program studimi.

PËRSHKRIM I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Histori” të ofruar nga Departamenti i Historisë pranë Universitetit të Tiranës filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Rudina Mita dhe Dr. Ejona Isufaj. Gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga menaxheri teknik i ASCAL, Majlinda Demirneli.

Vizita 2 ditore në Universitetin e Tiranës u realizua gjatë datave 25-26/07/2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL.

Gjatë ditëve të vizitës, në UT Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjës të Departamentit të Historisë, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore, etj. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.04.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/69 Prot, datë 07.04.2023. Më datë 12.05.2023 Universiteti i Tiranës njofton nëpërmjet shkresës Nr. 1066/3 Prot, datë 12.05.2023 “ Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Histori”, ku shpreh dakortësinë me vlerësimin e jashtëm të programit të studimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT

Standardi I.1			
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti i Tiranës është një universitet publik i cili ofron cikle të plota të programeve të të gjitha niveleve: të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Programet e studimit të këtij universiteti nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Në fokus të punës së tij si IAL, UT mbështetet në misionin e tij si një kontributor në zhvillimin e shoqërisë përmes tri qëllimeve të njesuara të IAL-ve: kërkim shkencor, edukim, shërbim ndaj publikut.		
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i statutit të Universitetit të Tiranës dhe Planit Strategjik të tij, GVJ vlerëson se programet e studimit, përfshirë programin Bachelor në “Histori”, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ndër të tjera Universiteti i Tiranës synon t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira të dijes dhe të shkencës si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare. (E.1.1, neni 5), (E.1.2,)		
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Histori” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e studiuesve dhe profesionistëve, në përgjigje të dinamikave dhe nevojave të tregut, përmes një filozofie bashkëkohore që ka në thelb Vlerat Universale. (E.1.1, neni 5), (E.1.2,)		
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit të UT-së dhe në përputhshmëri me qëllimet e Departamentit të Historisë, është hartuar dhe <i>Plani i Zhvillimit të këtij departamenti për periudhën 2021-2024</i> , duke u identifikuar si një alternativë profesionale dhe me mjaft peshë në fushën e arsimit në vend (specialiteti Histori). (E. 1. 4)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 5

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Histori” është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit i cili ka si objektiva strategjik, midis të tjerash, cilësinë dhe performancën akademike, kërkimin shkencor dhe inovacionin si dhe reformën kurrikulare në dy drejtime rishikimi i kurrikulave ekzistuese dhe hapja e kurrikulave të reja. Përmeshja e misionit të Universitetit të Tiranës (UT) planifikohet të realizohet dhe duke siguruar shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit. (E.1.2).</p>			
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në statutin e UT përcaktohen drejtimet prioritare akademike të tij formuluar në zbatim të përcaktimeve ligjore. Konkretisht në nenin 5 të tij, tek misioni, përcaktohet që: “Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimisht e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën”. Programi Bachelor në “Histori” është hartuar dhe ofrohet mbështetur në këtë mision. (E.1.1); (E.1.2)</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Histori” sigurohet në përputhje me fushat akademike dhe orientimet e institucionit. GVJ konsultoi gjithë dokumentacionin që lidhet me përmbajtjen e programit dhe konkludon që kjo përmbajtje përputhet plotësisht dhe integrohet natyrshëm në fushat e drejtimet akademike të UT-së. (E.1.1); (E.1.2); (E.1.5); (E.1.6);</p> <p>Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit që ofron Departamenti i Historisë konstatohet gjatë vizitës se ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet, fushat dhe drejtimet akademike dhe prioritetet e UT-së, të cilat burojnë nga Statuti, Rregulloja e UT- së dhe aktet e tjera rregullatore në fuqi në nivel institucional. (E. 1.5, neni 5 dhe 6)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi I.3**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Histori” i cili ofrohet nga Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, ka të përcaktuar qartë objektivat mbi aftësimin e studentëve, përfshirjen e kompetencave profesionale, aftësive dhe njohurive që studentët duhet të fitojnë deri në fund të programit të studimit, duke karakterizuar profilin e programit. Objektiva të programit të studimit mund të veçojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët të përfitojnë njohuri mbi përpunimin e shkrimit akademik si dhe aftësi të prezantimit të dijeve të tyre në publik; - Të jone të aftë të përzgjedhin, përpunojnë dhe analizojnë ngjarje të ndryshme historike; - Të kenë plotësuar formimin e tyre në fushën e Historisë së Shqipërisë dhe asaj Botërore; - Të përgatiten si specialistë të aftë profesionalisht, në gjendje të përgjigjen nivelit bashkëkohor të zhvillimit; <p>Në fokus të punës së Departamentit dhe të strategjisë së programit të studimit Bachelor në Histori, synohet që të përgatiten specialistë të aftë profesionalisht, të aftë t'i përgjigjen sfidave të zhvillimit bashkëkohor. (E.1.8); (E.1.6);</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (F.4- <i>Tregu i punes para hapjes se programit</i>), konstatohet se programi Bachelor në “Histori”, është ristrukturuar në përputhje me kërkesat e procesit të Bolonjës në vitin 2008, që solli riorganizimin e cikleve të studimit dhe të planeve mësimore. Për arsye të historikut të programit të studimit, <i>Institucioni nuk ka paraqitur studime të mirëfillta të kërkesave të tregut bazuar në këtë fushë.</i></p> <p>Referuar RVB-së, Departamenti ka kryer një studim lidhur me të diplomuarit në këtë program studimi. Në zbatim të strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, në vitin 2021 është zhvilluar gjurmimi i të diplomuarve në vitin akademik 2020-2021 në nivelin Bachelor, pranë Departamentit të Historisë. Formularët ishin plotësuar nga 67 të diplomuar në Departamentin e Historisë. (E. 1. 11); (F. 4);</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e</p>	<p>GVJ shqyrtoi kurrikulën e programit, përmbajtjen e syllabuseve, rezultatet e anketimeve të studentëve si dhe</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 7

<p>programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>pati takime me personelin akademik dhe studentët. Nëpërmjet këtij aktiviteti, GVJ u informua jo vetëm mbi objektivat formues, strukturën dhe përmbajtjen e PS por edhe rezultatet e arritura në përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave dhe konstaton që ato i përgjigjen plotësisht nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Programi është formësuar duke ofruar veprimtari mësimore-didaktike të formimit bazë teorik dhe praktik, nëpërmes moduleve mësimore, punës së pavarur, ekspeditës mësimore, eseve/punimeve si pjesë e kërkesave në lëndë të caktuara të këtij programi, praktikave mësimore, etj. (E.1.8); (E.1.6);(E.2.1).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UT/FHF ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në “Histori”.</p> <p>Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, i cili ka 6 (gjashtë) departamente :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Historisë; 2. Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore; 3. Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit; 4. Departamenti i Gjeografisë; 5. Departamenti i Gjuhësisë; 6. Departamenti i Letërsisë; <p>Burimet njerëzore: Stafit akademik bazuar në CV-të rezultoi me përvojë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit, me tituj e grada.</p> <p>Nga të dhënat që u morën gjatë vizitës në institucion (<i>Aneks RVB - Tabelat Permbledhese, Bsc ne Histori</i>) rezultoi se për vitin akademik 2021-2022 në nivel fakulteti ka (93 pedagogë PAE) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 23 Prof. Dr; - 27 Prof. Assoc;

	<ul style="list-style-type: none"> - 36 Dr/PhD; -- 7 Msc; <p>Personeli Akademik me kontrate (PAK) në nivel fakulteti është (119 pedagogë PAK).</p> <ul style="list-style-type: none"> - 23 Prof. Dr; - 12 Prof. Assoc; - 36 Dr/PhD; - 48 Msc; <p>Në Departamentin e Historisë, i cili është përgjegjës për programin e studimit, për vitin akademik 2021-2022 rezultojnë 15 pedagogë PAE dhe 10 pedagogë PAK (<i>Aneks RVB - Tabelat Permbledhese, Bsc ne Histori të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - 5 Prof. Dr; - 6 Prof. Assoc; - 8 Dr/PhD; - 6 Msc;
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Histori” është program studimi i ciklit të parë, që i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit i përket fushës së shkencave filologjike, me drejtim specifik në Histori. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit (Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë). Programi i studimit Bachelor në “Histori” siguron Diplomë Universitare Bachelor në “Histori”. Ky program organizohet dhe parqitet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit ECTS, në përfundim të të cilit studenti duhet të mbledhë 180 kredite ECTS. (<i>E. 1.6. neni 3</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Histori” ofrohet nga Departamenti i Historisë, në bashkëpunim me departamente të tjera të Fakultetit. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë (Departamentit të Historisë), përgjegjës për këtë PS. Ky program studimi i përket nivelit të 6-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. (<i>E.1.1, neni 89; neni 73 i Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH"</i>).</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Universiteti i Tiranës ka përcaktuar në organogramën e vet njësitë përbërse të tij ku bëjnë pjesë 8 njësi kryesore (fakultete) dhe rreth 41 njësi bazë (departamente). Marrëdhëniet midis tyre janë përcaktuar me ligje e dispozita ligjore në dokumentat themelore (statut, rregullore) si në nivel institucioni ashtu edhe në nivel njësisht dhe zyrash. Në shqyrtim të këtyre dokumenteve si dhe takimeve të organizuara, GVJ vleron se marrëdhëniet brenda institucionit janë bashkëpunuese me detyra të përcaktuara dhe me të drejta e përgjegjësi të njohura e të realizuara. (E. 1.3); (E. 1.7); (E. 1.1); (E. 1.2);
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Dokumentacioni i ofruar dëshmon që për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, UT, FHF dhe Departamenti i Historisë kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit. Departamenti ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe me institucione dhe subjekte të ndryshme, si Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Qendrën Kombëtare të librit dhe leximit, për të lehtësuar dhe ndihmuar procesin mësimor e akademik dhe mundësuar hapësirat e duhuara për studentët si edhe stafin akademik të këtij në vazhdë të arritjes së këtyre objektivave. (E.1.9; E. 1.10)
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i evidencave dhe kontaktet në institucion, rezulton se Departamenti i Historisë, ku ofrohet programi i studimit, në mënyrë periodike ka kryer vlerësim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera. Kryer kjo në varësi të interesit që ka departamenti lidhur me programet e studimit që ofron, mbështetur në reciprocitetin dhe korrektesën në bashkëpunim. Gjithashtu janë vlerësuar jo vetëm bashkëpunimet ekzistuese, por janë lidhur dhe marrëveshja të reja, që kanë si synim përfitimin e stafit dhe studentëve. (E.1.9; E.1.10)

<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Referuar RVB-së, lidhur me specifikat që paraqet ky program studimi, nuk janë zhvilluar praktika mësimore, pasi pjesë e planit mësimor janë ekspeditat mësimore të cilat janë të shtrira dhe zhvillohen në dy semestra në vitin e patë e të dytë të këtij program studimi. Ekspeditat mësimore synojnë të ndërthurin njohuritë teorike dhe zbatimin e tyre në praktikë nga ana e studentëve, të programit të studimit Bachelor në “Histori”. (E.1.8)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>UT dëshmon që ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. Në institucion funksionon tashmë Zyra e Karrierës e cila i trajnon studentët si të aplikojnë për punë, si të shkruajnë një CV apo letër motivimi. Gjatë takimit në zyrën e karrierës mësuam se nga kjo zyrë organizohet dhe “Java e Karrierës” një aktivitet, siç u pohua dhe nga studentët, mjaft i dobishëm për ta. Nga vizita në institucion rezultoi se IAL ka firmosur marrëveshje bashkëpunimi ndërinstytucional me entitete publike dhe private.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p>Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Histori” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në “Histori” përmban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar.</p>

	<p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. (E. 1.1, neni 89; E. 1.3, neni 3, 1E.1.6, neni 3; E.1.8).</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi mësimor i studimit Bachelor në “Histori” është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, Datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Programi i studimit Bachelor në “Histori” i korrespondon Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Programi i studimit si objektiv të tij ka formimin e studentëve me njohuritë bazë specifike në fushën e historisë. Vetë programi i studimit synon të realizojë një kombinim mes formimit akademik me aspektin praktik, kryesisht në varësi të lëndëve të caktuara. Mundësitë që kanë studentët që ndjekin këtë program studimi, në drejtim të formimit të tyre të mëtejshëm akademik, vijojnë dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, Master i shkencave apo Master profesional, përpos vazhdimësisë së karrierës së tyre profesionale duke i mundësuar punësimi në sektorin publik apo privat. Programi në kurikulën e tij përmban veprimtari mësimore-didaktike me qëllim që studentët të përfitojnë një njohuri të shumta përmes ndjekjes së leksioneve, seminareve ndërthurur dhe me aktiviteteve ekstra-kurrikulare. Programi i studimit në vetvete ka si qëllim dhe synon formimin përmes përgatitjes të specialistëve profesionalë, në kuadër të nivelit bashkëkohor të zhvillimit. (E. 1.6. neni 2).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Studentët që ndjekin këtë program studimi përfitojnë një sërë njohurish nëpërmjet leksioneve, seminareve, ekspeditave në terren dhe aktiviteteve të tjera të ofruara nga Departamenti. Ky program studimi synon që: Studentët të përfitojnë formimin e tyre në fushën e Historisë së Shqipërisë dhe asaj Botërore, një sërë njohurish nëpërmjet leksioneve, seminareve por edhe aktiviteteve të shumta ekstra-kurrikulare të ofruara nga Departamenti. Përveç njohurive akademike rezultojnë gjatë vizitës se kërkohet të njihen studentët edhe me njohuri teknike në lidhje me përpunimin e informacionit, shkrimin akademik si dhe aftësi të prezantimit të dijeve të tyre në publik. Në këtë program studimi synohet t’u ofrohet studentëve shqiptarë dhe studentëve të hapësirës shqip-folëse, përvoja e duhur në marrjen e ekspertizës më profesionale nga ana e profesorëve të Departamentit të Historisë, por edhe në bashkëpunim mes</p>

	tyre, të qendrave më të mira studimore dhe akademike në Shqipëri;
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ndër objektivat formuese të programit të Ciklit të Parë të studimit Bachelor në “Histori”, është t’u japë studentëve njohuritë bazë dhe më bashkëkohore të nevojshme në fushën e Historisë, mbështetur në këndvështrimin e thellimit të njohurive në ciklet e larta të studimit duke patur edhe si qëllim kërkimin shkencor në të ardhmen. Gjatë vijimit të këtij programi studimi studenti merr njohuri/aftësi të nevojshme por edhe mundësinë për të vijuar arsimimin në programe të ciklit të dytë të studimeve (MS H apo MP). Programi i studimit u siguron studentëve dhe aftësimin profesional lidhur me orientimin e tij në aspektin praktik e profesional në fushën e historisë apo disiplina të ngjashme të humaniteteve. Oferta akademike që ofrohet për studentët e këtij programi studimi i nxit ato për të vijuar arsimimin në programe të ciklit të dytë të ofruara nga departamenti i historisë. <i>E.1.6, neni 2, E.1.5, neni 7 dhe 15; E.1.8; E.1.11;</i>
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Histori” përmban të shprehura në mënyrë eksplicite shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënës, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, etj. <i>(E.2.1). (E.1.6); (E.1.8)</i>
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Referuar Rregullores së tij, ky program studimi, organizohet në module/lëndë që vlerësohen në kredite ECTS. Programi i studimit, veprimtaritë formuese i grupon në kategoritë e mëposhtme, me kreditet dhe përqindjen përkatëse që zënë, sipas përcaktimeve të bëra mbi bazën e VKM-së së sipërpërmendur (VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar): GVJ konstaton se lëndët/modulet janë grupuar sipas veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, më poshtë: A. LËNDË BAZË-36 kredite ose 20 %; B. LËNDË KARAKTERIZUESE-96 kredite ose 53.3%; C. LËNDË NDËRDISIPLINORE -22 kredite ose 12.2%; D. LËNDË PLOTËSUESE -18 kredite ose 10 %;

	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE-8 kredite ose 4.4%; <i>(Aneks RVB-Tabelat përmbledhëse); (E.1.5, neni 20);(E.1.8).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Institucioni UT-ës ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27. 10. 2018 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike. Fakulteti i Histori Filologjisë si njësi kryesore është i organizuar në 6 njësi bazë të cilat plotësojnë kërkesat ligjore në fuqi për sa i përket numrit të stafit akademik dhe kriterëve të kualifikimit shkencor të tij. Departamenti i Historisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit plotëson kriteret ligjore dhe ka një staf akademik të kualifikuar dhe me eksperience në fushën e Historisë. <i>(E.1.3);</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Në kuadër të organizimit dhe mirëfunksionimit të veprimtarisë në Departamentin Histori me urdhër të drejtuesit të departamentit është përcaktuar (miratuar) koordinatori i programit të studimit, pjesë e personelit akademik me kohë të plotë në departament. Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit, ai përgjigjet për ecurinë dhe zhvillimin normal të tij, si dhe koordinon veprimtarinë mësimore me veprimtari të tjera në mbështetje të qëllimit dhe objektivave të programit të studimit bachelor në Histori, por dhe në ecuri me objektivat e departamentit. <i>(E.2.3).</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Bazuar në DVV dhe dokumentacionin e siguruar nga vizita në IAL, GVJ konstaton se FHF si njësi kryesore, dhe Departamenti i Histori si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Njësia kryesore përbëhet nga 6 departamente:
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit,	1. Departamenti i Historisë; 2. Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore;

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 14

përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

3. Departamenti i Gjeografisë;
 4. Departamenti i Gjuhësisë;
 5. Departamenti i Letërsisë;
 6. Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit;
- Njësia bazë për PS Bachelor "Histori është Departamenti i Historisë.

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në vitin akademik aktual 2021-2022, ka 212 staf akademik gjithsej, ku 93 janë pedagogë me kohë të plotë, dhe 119 pedagogë me kohë të pjesshme.

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	PAE	PAK
Prof. Dr.	23	23
Prof. As. Dr.	27	12
Dr. / PhD.	36	36
MSc.	7	48
Totali	93	119
	212	

GVJ konstaton se Departamenti i Historisë në vitin aktual 2021-2022, ka 25 personel akademik gjithsej, 15 pedagogë me kohë të plotë dhe 10 pedagogë me kohë të pjesshme me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi	2021-2022	
	PAE	PAK
Prof.	4	1
Prof. Asoc.	5	1
Dr.	5	3
MSc.	1	5
Totali	15	10

Për sa më sipër GVJ konstaton se Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

(E 1.1, neni 14 dhe 20; E.1.5, neni 9, neni 12) E.2.1 dhe E.2.2)

Shkalla e përmbushjes së standardit

Përmbushet pjesërisht

Përmbushet kryesisht

Përmbushet plotësisht

X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																										
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ konstaton se Departamenti i Historisë disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren e programit mësimor, Syllabuset, orarin, ngarkesën e stafit akademik etj. Dosja e plotë e çdo viti mbahet në departamentin përkatës. (E.1.5; E.1.6; E.1.8; E.2.1)																										
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>Programi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="587 840 1353 1489"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria /</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th> <th colspan="2">Programi Bsc. Histori</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>Përqindje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. LËNDË BAZË</td> <td>15%-20%</td> <td>36</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>50%- 55%</td> <td>96</td> <td>53.3%</td> </tr> <tr> <td>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE</td> <td>12%-15%</td> <td>22</td> <td>12.2%</td> </tr> <tr> <td>D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)</td> <td>10%-15%</td> <td>18</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>3%- 5%</td> <td>8</td> <td>4.4%</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi Bsc. Histori		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	15%-20%	36	20%	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 55%	96	53.3%	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-15%	22	12.2%	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%-15%	18	10%	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%- 5%	8	4.4%
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM			Programi Bsc. Histori																							
		Kredite	Përqindje																								
A. LËNDË BAZË	15%-20%	36	20%																								
B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 55%	96	53.3%																								
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-15%	22	12.2%																								
D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%-15%	18	10%																								
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%- 5%	8	4.4%																								
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton e shprehur qartë shpërndarja e krediteve në gjashtë semestra dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit. Programi i studimit Bachelor në “Histori ” rezulton me 30 kredite për semestër, 60 kredite në një vit të plotë akademik dhe tre vite akademike. Në planin mësimor të programit të studimit, ndarja e orëve mësimore në auditor, në orë për leksione e seminare, për çdo disiplinë, përcaktohet, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë e këtij programi. Sipas planit mësimor në një vit akademik studenti duhet të																										


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 16




	<p>grumbullojë 60 kredite ECTS dhe për tre vite të vijimit të programit të studimit, pra në përfundim të studimeve, studenti duhet të grumbullojë 180 kredite ECTS.</p> <p><i>(E.1.5, neni 20-21; E. 1.6, neni 3, E.1.8).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor për programin Bachelor në “Histori” bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ngarkesën mësimore, e cila përfshin ngarkesën orë në auditor, orët jashtë auditorit; - Orët gjatë një viti, 1.500 orë mësimore punë të studentit; - Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm është deri në 25 (njëzetepesë) orë mësimore 50-minutëshe; <p>Kreditet që i korrespondojnë çdo veprimtarie formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhduar me atë përfundimtar. Rregullat për frekuentimin/ndjekjen e programit, si dhe vlerësimin e njohurive përcaktohen në rregulloren e programit, si dhe në syllabus-et e lëndëve. Në lidhje me frekuentimin, frekuentimi i leksioneve është fakultativ, frekuentimi i seminareve është i detyruar në masën 75%. <i>(E.1.5, neni 15-21; E.1.6, neni 3, E.1.8:)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Histori” përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Njësia bazë departamenti, propozon kuotat të cilat miratohen konform rregullores dhe statutit të UT në instancat me të larta. Kriteret e pranimit dhe të transferimit të studimeve, njohjes se krediteve janë përcaktuar dhe publikuar në faqen zyrtare të FHF.</p> <p>https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit ëëë.flif.edu.al/flif-kriteret-e-pranimit-per-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-per-vitin-akademik-2022-2023</p> <p><i>(E.1.3; E.1.6., neni 4).</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, ato integrojnë elementët në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimin e lëndës;

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 17

komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<ul style="list-style-type: none"> • Ngarkesën e lëndës në kredite; • Semestrin kur zhvillohet lënda; • Përshkrimin dhe objektivat e lëndës; • Rezultatet dhe kompetencat e mësimit; • Kontributin e lëndës në rezultatin e programit; • Detyrimet e lëndës; • Literaturën bazë; • Literaturën ndihmëse; • Mënyrën e vlerësimit, detajuar me detyrimet e studentit, kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e vlerësimit me notë; • Përmbajtjen e temave të kursit; <p>(E.2.1);</p>								
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ konstaton se stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik. Sipas RVB, programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. (E.1.5); (E.1.6);								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 875 738 958"></th> <th data-bbox="738 875 943 958">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="943 875 1139 958">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1139 875 1370 958">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 958 738 1010"></td> <td data-bbox="738 958 943 1010"></td> <td data-bbox="943 958 1139 1010"></td> <td data-bbox="1139 958 1370 1010" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.											
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Histori” është i organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total. Konstatohet se ky organizim është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndarja e orëve mësimore është si më poshtë: <table border="1" data-bbox="582 1585 1343 1886"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1585 991 1641">Format e mësimdhënies</th> <th data-bbox="991 1585 1343 1641">Bsc Histori</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1641 991 1697">Leksione</td> <td data-bbox="991 1641 1343 1697">1140 (auditor)</td> </tr> <tr> <td data-bbox="582 1697 991 1753">Seminare</td> <td data-bbox="991 1697 1343 1753">495 (auditor)</td> </tr> <tr> <td data-bbox="582 1753 991 1821">Ekspeditë mësimore</td> <td data-bbox="991 1753 1343 1821">250</td> </tr> <tr> <td data-bbox="582 1821 991 1886">Studim individual</td> <td data-bbox="991 1821 1343 1886">2415</td> </tr> </tbody> </table>	Format e mësimdhënies	Bsc Histori	Leksione	1140 (auditor)	Seminare	495 (auditor)	Ekspeditë mësimore	250	Studim individual	2415
Format e mësimdhënies	Bsc Histori										
Leksione	1140 (auditor)										
Seminare	495 (auditor)										
Ekspeditë mësimore	250										
Studim individual	2415										

	Diplomë/provim formimi	200
	Totali	4500
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. (E.1.5 dhe E.1.6). Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka 15 javë. Çdo javë ka 20-25 orë mësimi leksione, seminare, ekspedita mësimore (E.1.5, neni 17). Lëndët janë semestrale dhe së bashku me kreditet (ECTS) janë të pasqyruara në planin mësimor të miratuar.</p> <p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit, ndarja në kategori e veprimtarive formuese, shpërndarja e lëndëve mundëson njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të vijuar me arsimimin e tyre në ciklin e dytë, apo për ata që nuk do vijnë më tej në programe të tjera, mundëson aftësi të nevojshme në fushën e Historisë për punësimin e tyre. Lëndët e formimit bazë zhvillohen të gjitha në vitin e parë të studimeve, ndërsa ato karakterizuese në vitin e dytë dhe të tretë, sipas specifikave të tyre dhe duke ndjekur një kronologji dhe logjikë shkencore të ndarjes dhe zhvillimit të tyre në semestra. Këtyre lëndëve u bashkohen edhe lëndët me zgjedhje, si një mundësi e studentit për të marrë njohuri dhe zhvilluar aftësi në lëndë të caktuara, që i përkasin grupit të lëndëve ndërdisiplinore/integruese.</p> <p>Praktika mësimore në terren i vjen në ndihmë studentëve të gërshetojnë teorinë dhe praktikën në procesin e studimit të historisë dhe gjeografisë. Gjithashtu edhe gjuha e huaj (anglisht) është pjesë e lëndëve plotësuese në këtë program studimi.</p> <p>Studentët marrin njohuri dhe aftësi me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e historisë, duke iu përshtatur gjithnjë e më shumë zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë dhe zhvillimit të vendit/tregut të punës. Nëpërmjet një gërshetimi të mirorganizuar të anës teorike me praktikën departamenti, sjell risi në mënyrën e aftësimin dhe të përgatitjes së studentëve përmes programit të studimit Bachelor në histori, me qëllim për të hedhur bazat në përgatitjen e historianëve të ardhshëm, ekspertëve të marrëdhënieve ndërkombëtare, arkivistikës, etj. Gjithashtu, synohet ofrimi në tregun e punës të profesionistëve të aftë dhe të pajisur me njohuritë më të përditësuara jo vetëm nga ana teorike, por me një vëmendje të veçantë në aspektet praktike dhe analitike për zhvillimin sa më profesional të</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 19




	studimeve dhe reflektimeve historike. (E.1.5, neni 5-6).
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.	Nga vlerësimi i planit mësimor, GVJ konstatoi se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në fushën e historisë. (E. 1.8; <i>Aneks RVB- Tabelat përmbledhëse</i>). Ndërtimi i këtij programi i përshtatet ndryshimeve dhe zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë, për vijimin e mëtejshëm të studimeve në programe të ciklit të dytë dhe formimit/aftësimit profesional. (E.1.5, neni 6; E.1.6, neni 2).
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor në Histori dhe Gjeografi” është hartuar duke mbajtur parasysh përcaktimet në lidhje me strukturën e këtij programi sipas kriterëve të vendosura nga VKM 41 (e sipërpërmendur) si dhe në përputhje me Statutin dhe aktet e tjera të UT-së. (E.1.5, neni 8; E.1.8; E.1.4)
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ është i mendimit se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Nga vizita në institucion dhe takimet me studentë e personelin akademik GVJ ka konstatuar një përputhje të mirë të këtij program studimi me programe analoge Programi synon përgatitjen e profesionistëve të aftë në fushën e historisë, por edhe në aftësimin e tyre në të ardhmen në ndjekjen e studimeve jashtë vendit, në përfshirjen në projekte të ndryshme bashkëpunuese, si dhe duke krijuar një terren të favorshëm për përgatitjen e ekspertëve të marrëdhënieve ndërkombëtare, mjaft të favorizuar sot në tregun e punës. (E.1.5, neni 5-6; E.1.8; E.1.4).
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Programet e lëndëve/moduleve në këtë program studimi janë përditësuar në mënyrë të vazhdueshme, në funksion të marrjes së kompetencave në vazhde të zhvillimit të profilit të specialistit që diplomohet. Profil, i cili përshtatet me kërkesat e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Mësuesi për Histori, Master i Shkencave në Histori. Programet lëndorë mbi bazën e konstatimeve të kryera, përfshijnë jo vetëm literaturën bazë por edhe literaturën ndihmëse, sidomos atë të

	<p>viteve të fundit, duke i mbajtur studentët në kontakt me interpretimet e reja historiografike dhe shkencore apo me burimet e reja dokumentare të publikuara.</p> <p>Syllabusi i lëndës/ve është obligim i titullarit të saj/tyre, i cili hartohet në kohën e duhur në përputhje me planin mësimor. Nga ana e dokumentacionit një kopje e tij dorëzohet në Departament dhe firmoset nga përgjegjësi i departamentit. Nevoja e përditësimit të syllabuseve mbështetet sipas zhvillimeve në fusha/specialitete, mbështetur në propozimet të titullarit të lëndës, si dhe diskutimeve në departament. Pasurimi i literaturës që pasqyrohet në syllabuset e lëndëve, u përcillet dhe studentëve të këtij programi studimi. (E.2.1; E.1.8; E.1.5, neni 11, pika 4/a).</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Histori”, i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të parë. Nga takimet me studentët rezultojnë se realizimi faktik i programit të studimit përmbush kërkesat dhe është brenda pritshmërive të tyre. Gjithashtu studentët vlerësuan pozitivisht menaxhimin nga ana e personelit akademik të mësimit online.</p> <p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për lëndën përkatëse: emërtimi dhe kreditet e lëndës, titullari/asistenti (nëse ka), viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi i lëndës në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore, rezultatet e të nxënësve, njohuritë dhe aftësitë që lënda synon të japë studentit, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar, etj. (E.2.1; E.1.4; E.1.8; E.1.5, neni 4, neni 6).</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Histori synon mundësimin e një formimi akademik nxitës dhe konkurrues, në vend në kuadrin e programeve të njehta e të përafërta të studimit të IAL-ve, ofrimin e mundësive për thellim të mëtejshëm të dijeve për studentët të cilët synojnë të kualifikohen më tej në fushën e historisë dhe gjeografisë.</p> <p>Në misionin e tij Departamenti i Historisë për programin mësimor “Bachelor në Histori” synon përgatitjen e studentëve si studiues e profesionistë, në përputhje me kërkesat e kohës dhe tregut të punës, si dhe në përputhje me <i>Strategjinë, e zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023</i>. Programi, ka në thelb përgatitjen e profesionistëve të aftë në fushën e historisë, por edhe në aftësimin e tyre në të ardhmen.</p>

	<p>në ndjekjen e studimeve jashtë vendit, në përfshirjen në projekte të ndryshme bashkëpunuese, si dhe duke krijuar një terren të favorshëm për përgatitjen e ekspertëve të marrëdhënieve ndërkombëtare, mjaft të favorizuar sot në tregun e punës. (EV. 1.4), (EV. 1.8), (EV. 1.20), (EV. 3.15), (EV. 3.16), (EV. 3.17)</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni në përgjithësi si dhe FHF dhe Departamenti i Historisë në veçanti, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm nga tregu i punës, kanë synuar nga njera anë përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut e punës dhe nga ana tjetër ofrimin dhe njohjen e studentëve me këtë treg. Programi i studimit Bachelor në “Histori” në punën e tij thellohet në drejtim të vlerave thelbësore të universitetit, si angazhimi intelektual, komuniteti, integriteti, inovacioni dhe gjithëpërfshirja (E.1.6, neni 2; E.2.9).</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>							
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>						
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV (<i>Aneks RVB - Tabelat Permbledhese tab 6.1, 6.2 dhe 6.3, Bsc ne Histori</i>), rezulton se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p>						
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Kualifikimi i stafit akademik të PS</p>	<p>2019-2020</p>		<p>2020-2021</p>		<p>2021-2022</p>	
		<p>PAE</p>	<p>PAK</p>	<p>PAE</p>	<p>PAK</p>	<p>PAE</p>	<p>PAK</p>
	<p>Prof. Dr</p>	<p>4</p>	<p>1</p>	<p>4</p>	<p>1</p>	<p>4</p>	<p>1</p>
	<p>Prof. Asoc.</p>	<p>3</p>	<p>1</p>	<p>5</p>	<p>1</p>	<p>5</p>	<p>1</p>
	<p>Dr/Phd</p>	<p>6</p>	<p>3</p>	<p>4</p>	<p>5</p>	<p>5</p>	<p>2</p>
	<p>Msc.</p>	<p>2</p>	<p>4</p>	<p>2</p>	<p>6</p>	<p>1</p>	<p>5</p>
	<p>Gjithsej</p>	<p>15</p>	<p>9</p>	<p>15</p>	<p>13</p>	<p>15</p>	<p>9</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e</p>							

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 22

<p>anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Mbulimi i programit në përqindje sipas viteve akademike referuar numrit të Personelit akademik të angazhuar është:</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, 63% PAE dhe 37% PAK; Për vitin akademik 2020-2021, 54% PAE dhe 46% PAK; Për vitin akademik 2019-2020, 63% PAE dhe 37% PAK</p> <p>Ndërsa përsa i përket ngarkesës mësimore të realizuar, për vitin 2021-2022 (<i>Aneks RVB - Tabelat Permbledhese, tab 12.1, Bsc ne Histori</i>).ajo është përballuar në masën rreth 78% nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe 22% nga personeli akademik me kontratë(PAK).</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik rezulton:</p> <p>Për vitin 2019 – 2020, 75% e pedagogëve kanë tituj akademik / gradë shkencore, 25% janë Msc; Për vitin 2020 – 2021, 71% e pedagogëve kanë tituj akademik / gradë shkencore, 25% janë Msc; Për vitin 2021– 2022, 75 % e pedagogëve kanë tituj akademik / gradë shkencore, 25% janë Msc;</p> <p>Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të stafit akademik dhe programit mësimor, GVJ konstaton se për të tre vitet akademike, 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022, programi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përmbush kërkesën ligjore të të pasurit së paku kualifikimin e një cikli pasardhës për të gjithë stafin akademik që mbulon programin akademik; - niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe</p>	<p>Nga konstatimet e kryera rezulton se departamenti ka angazhuar pedagogët e tij në ekspeditën mësimore, përmes të cilave studentët e këtij programi studimi iu është mundësuar njohja nga afër me njohuritë që kanë marrë në lëndët teorike në auditor. Në këtë program studimi nuk është përcaktuar praktika profesionale. (<i>E.1.8</i>).</p> <p>Diplomimi i studentëve në këtë program studimi mund të realizohet me provim përfundimtar dhe me temë diplome. Për ata që diplomohen me temë, mbahen parasysh kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në rregulloren e programit të</p>


veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	studimit. (E.1.6, neni 15). Për udhëheqjen e diplomës, stafi akademik udhëheqës është me tituj dhe grada si pjesë e stafit akademik të brendshëm të departamentit. Për temën e diplomës studenti udhëhiqet nga një pedagog i departamentit, i cili ka dhënë miratimin e tij dhe ajo mbrohet para komisionit të ngritur për këtë qëllim. (E.1.6, neni 14/ dhe 15).			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar DVV, Departamenti i Historisë në programin e studimit angazhon edhe personel ndihmës akademik, në ndihmë të realizimit të veprimtarisë akademike. Konkretisht këtë rol në këtë program e luan laborantja e departamentit (E.1.5, neni 9). Procesit mësimor i vjen në ndihmë edhe zyra e IT-së e Fakultetit si për stafin ashtu edhe për studentët. Kjo është evidentuar ndjeshëm dhe në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 dhe zhvillimin e mësimin në platformat online, përmes të cilit asistenca e specialistit të IT-së ka luajtur rol të rëndësishëm për të mundësuar/lehtësuar qasjen e studentëve në platformat online (Microsoft Teams) dhe marrjen e informacionit në lidhje me procesin mësimor, si: leksione/seminare, provime, pyetësor, etj. (E.1.8; E.2.5; E.2.6, neni 24; E.2.7; E.2.8).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të	GVJ u informua se Departamenti i Historisë inkurajon dhe mbështet të gjithë format dhe metodat në mësimdhënie të cilat kontribuojnë në aftësimin e studentit. Mësimdhënia

<p>ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>organizohet bazuar në aktet rregullatore si Statuti dhe Rregullorja e UT, Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e Programit të Studimit. Një sfidë e veçantë, me elementë të së cilës u njoh GVJ, ka qenë organizimi i mësimin online në kushtet e pandemisë. Ky problem u trajtua në rang institucioni duke hartuar udhëzuesin për mësimin në distancë si dhe trajnime për stafin akademik për përdorimin e platformave përkatëse. (E.2.5.- <i>Udhëzues i UT per mesimin ne distance</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Referuar dokumentacioni të vënë në dispozicion si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që edhe për programin Bachelor në “Histori” strukturat përgjegjëse (institucioni, fakulteti dhe departamenti) kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Si organizëm për sigurimin e cilësisë edhe në këtë institucion është ngritur rishtazi (dhjetor 2021) dhe vepron NJSBC e cila, mbështetur në rregulloren e saj, ka për detyrë, që në përfundim të çdo viti akademik të analizojë rezultatet e monitorimit të grupeve të ngritura prej saj dhe këtë analizë t’ja përcjellë senatit akademik dhe bordit të administrimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është ngritur edhe në nivel fakulteti në përbërje të së cilës ka pedagogë dhe një student (ku përfaqësuesja studentore në këtë njësi është anëtare e departamentit të historisë). Krijimi i kësaj strukture synon të lehtësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin me strukturat e tjera në funksion të garantimit të cilësisë. (E.3.1; E.3.2; E.3.3).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në takimet e GVJ me studentët dhe me personelin akademik u konstatua se në fund të çdo semestri, dhe për çdo vit janë organizuar pyetësorë anonimë me studentët mbështetur në një format të adoptuar nga UT. Këto vlerësime ishin të pavarura dhe të paanshme. GVJ gjykon që ato kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së veprimtarive akademike. Nëpërmjet këtyre pyetësorëve merret opinioni i studentit në lidhje me strukturimin e lëndëve, metodat e të nxënit dhe të mësimdhënies, logjistikën e auditorëve, literaturën e përdorur, materialet mësimore, cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin e studentit, pedagogun (metodat e mësimdhënies, mënyrën e spjegimit, përgjigjet e pyetjeve etj.), detyrimet e lëndës (detyrat, komentet e marra). Ankimimi si e drejtë e studentit është i parashikuar në aktet</p>


	rregullatore të brendshme të institucionit dhe në rastin konkret lidhet me vlerësimin në tezën e provimit. Kjo e drejtë i jep mundësinë studentit të kryejë ankimimin me shkrim brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultateve. Procedurat e ankimit rregullohen në Rregulloren e UT-së dhe rregulloren e programit të studimit. (E.1.3, nenet 50-31).			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ u informua se pas përpunimit statistikor dhe cilësor, të dhënat e përfuara nga vlerësimet pasqyrohen në departament, duke iu nxjerrë në pah stafit akademik dhe ndihmës akademik, vlerësimet lidhur me performancën akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, vlerësimet në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të shërbimeve që ofrohen nga fakulteti dhe njësitë përbërëse të tij. (E.3.4: E.1.7).			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Në veprimtarinë e saj NJSBC, zbaton “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, mbështetur njëkohësisht në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumentave të Cilësisë”, miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23 Dhjetor 2020. Përpunimi i rezultateve të pyetsorëve kontribon jo vetëm në adresimin e problematikave, por edhe në evidentimin e praktikave më të mira me synim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Nga ana tjetër, referuar RVB, DSBC në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse (Komisioni Institucional për Vlerësimin e Standarteve të Cilësisë) organizojnë trajnime tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies apo në funksion të përmirësimit të cilësisë, sipas një kalendari që hartohet për këtë qëllim në fillim të vitit akademik. (E.3.1).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e	Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët esetë dhe detyrat e kursit. Këto forma zhvillohen në përputhje me ngarkesën e parashikuar për çdo lëndë dhe sipas përmbajtjes të përcaktuar në syllabuset e lëndëve

<p>hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>përkatësisht moduleve. GVJ konstatoi se format klasike të mësimdhënies ndërthuren me metoda të ndryshme bashkëkohore. Gjithashtu ka raste kur organizohen edhe leksione nga lektorë të fuar.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Nga vizita në institucion është verifikuar se stafi pedagogjik i përgjigjet me seriozitet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Pedagogët në përputhje me natyrën e programit ofrojnë metoda dhe mundësi alternative (shembuj realë, etj.). Personeli akademik në lidhje me mësimdhënien respekton rregullat e institucionit, mbi mënyrën e zhvillimit të orës së mësimit, vlerësimin e studentëve, literaturën dhe materialet që u ofrohen atyre, etj. Duke qenë se çdo lëndë ka specifikat e saj, dhe kështu pedagogu zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies, të aktivizimit të studentëve, duke kombinuar aspektin teorik më të diskutimeve dhe trajtim it praktik, etj. (E.2.1; E.1.8)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se për përmirësimin e kompetencave didaktike, përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, veprohet në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë të paisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies si dhe nëpërmjet modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gatishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor; • Krijimi i oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies; • Realizimi i trajnimeve, pjesëmarrja në konferenca, aksesit në platforma kombëtare dhe ndërkombëtare, përmirësime të vazhdueshme në pedagogji; • Përdorimi i modeleve të vlerësimit të harmonizuara me të mësuarit me në qendër studentin; • Përdorimi i platformave inovative të të mësuarit (përdorimi i Microsoft Teams, etj).
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë dhe se kanë shkallën e kërkuar të kualifikimit për të mbuluar zhvillimin cilësor të mësimit në ciklin e studimeve Bachelor</p>

	<p>Studentët kanë përfituar nga dhënia e njohurive dhe metodologjia e përdorur përmes gërshetimit të aspektit teorik me atë praktik, pjesëmarrja aktive e tyre në trajtime konceptesh e interaktiviteti gjatë zhvillimit të orës së mësimi, në varësi të temave të parashtruara në syllabus-in e lëndës. (E.2.1: E.2.2).</p> <p>Gjithashtu nga takimi i zhvilluar me studentët, rezultoi se mendimi i tyre është se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ nga inspektimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion vëren se personeli akademik i Departamentit të Historisë vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre, të cilat pasqyrohen tek pyetësi i vlerësimit të performancës për pedagogët (E. 1.2, pika 1-Mësinidhënia dhe studentët).</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Nga biseda me personelin akademik dhe me studentët, GVJ verifikoi se gjatë orëve të seminareve dhe leksioneve vihen në përdorim një numër i madh shembujsh realë. në mënyrë që ora mësimore të bëhet sa më tërheqëse dhe të nxitet diskutimi në lidhje me tematikën në fjalë.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ, nga konsultimi i planeve mësimore, metodat e përdorura në mësimdhënie që nxisin autonominë tek studentit, i cili fillimisht punon nën mbikëqyrjen e pedagogut dhe më pas fillon të punojë në mënyrë graduale si i pavarur, është në gjendje të zgjidhë vete problemet e ndryshme në fushën e studimit.</p> <p>Personeli akademik në leksione/seminare përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore, sipas natyrës dhe specifikave të lëndës, me qëllim interaktivitetin dhe të menduarin kritik të studentëve të këtij programi studimi. Te studentët është nxitur dhënia e mendimit/qëndrimin të tyre kritik për çështje të caktuara që diskutohen, raste apo tema e çështje të ndryshme. Marrëdhënia mes pedagogëve dhe studentëve është ndërtuar si marrëdhënieve mbi bazën e respektit të ndërsjellë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Mësimi në FHF realizohet në salla cilësore dhe me hapësira të mjaftueshme për studentët e këtij programi studimi, si dhe të programeve të tjera që ofron ky fakultet, të cilat mirëmbahen rregullisht nga punonjësit e mirëmbajtjes dhe sanitaret në institucion, çka u konstatua gjatë vizitës së GVJ në këtë institucion. (E.3.7).
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Referuar RVB dhe nga vizita e ambienteve, GVJ konstatoi se sallat e leksioneve, seminareve, laboratorëve, etj, janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si: kompjutera, video-projektor, ekrane projektimi, flipchart, servera etj, duke mundësuar që mënyra e realizimit të mësimdhënies të bëhet me metoda e teknologji bashkëkohore dhe në përputhje me specifikat e lëndëve. Gjithashtu, baza laboratorike kompjuterike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor. Ambientet janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi për të mundësuar qasjen lirisht online. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së IT së FHF-së. (E.3.7; E.1.7).
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	GVJ konstaton se programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore, me programet aplikative të kërkuara. Në dispozicion të programit është edhe platforma Microsoft Teams, për mësimin online apo aktivitete të tjera akademike (seminare/konferenca). Sistemi i mundëson studentit në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audiovizive, etj. Nga vizita në institucion rezultoi se studentët kanë mundësi të komunikojnë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët, si dhe kolegët e kursit që ndjek; të shikojë notat dhe pikët <i>on-line</i> nga kudo që ndodhet, etj. (E.3.7; E.2.5; E.2.6; E.2.8)
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	GVJ, përmes shqyrtimit të evidencave konstaton se syllabus-et e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar për lëndën (EV. 3.17). Literatura kryesore është në gjuhën shqipe, si gjuhë e programit të studimit “Bachelor në Histori”, i cili aksesohet përmes publikimeve të ndryshme por edhe në rrugë elektronike, si pjesë e literaturës së qasshme on-line. Syllabus-et pasurohen nga titullari i lëndës përmes

	<p>përditësimi të informacionit të sugjeruar studentëve sipas specifikave dhe lëndëve që zhvillojnë.</p> <p>Studentëve iu ofrohet dhe qasja në biblioteka online, pa pagesë, si: JSTOR, si dhe në bibliotekën online të UT, në lidhje me informacionin e nevojshëm në këtë link: https://unitir.edu.al/biblioteka-online</p> <p>Literatura e rekomanduar si pjesë e rëndësishme e syllabuseve të lëndëve dhe përditësimi i saj synon garantimin e marrjes së dijeve të nevojshme në këtë program studimi.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë, dhënia e materialeve online ka qenë një praktikë e zbatuar përmes platformës online M. Teams, gjë që ka lehtësua aksesin e këtyre materialeve të nevojshme për lëndën. (E.2.1: E.3.7; E.2.5; E.2.6: E.2.7: E.2.8)</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Literatura e programit të studimit kryesisht ruhet fizikisht në bibliotekë. Biblioteka pasurohet në fillim të çdo viti akademik. Të gjithë lektorët mund të propozojnë titujt, që mund të shtohen në bibliotekë. Biblioteka e FHF-së ka një ambient të bollshëm i pajisur me 70 vende dhe një sipërfaqe rreth 82.5 m². (Aneks RVB- Tabelat përmbledhëse).</p> <p>Referuar RVB-së Biblioteka është e pajisur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Libra në hard copy (të printuar), Bruto, Periodikë, CD & tituj e harta- 165.000; • Libra në gjuhën shqipe tituj: rreth 70% e fondit; • Libra në gjuhë të huaj tituj: rreth 30% e fondit; • Periodikë total: përafërsisht 10.000; • Periodikë në gjuhë të huaj 67 tituj;
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ, përmes shqyrtimit të evidencave dhe vizitës në institucion konstaton se në dispozicion të studentëve, por edhe të stafit, janë edhe bibliotekat online, si: JSTOR (pjesë e marrëveshjes së UT-së me AADF). Gjithashtu, funksionin edhe biblioteka online e UT, ku çdo student mund të qaset tek informacioni i nevojshëm. https://unitir.edu.al/biblioteka-online (E.3.7; E.3.8).</p> <p>Për lehtësimin e përdorimit të librarisë digjitale, është hartuar edhe një manual për përdorimin, si dhe lidhja për qasjen tek ajo, dhe faqja web e UT.</p> <p>https://ulibrary.rash.al/ https://unitir.edu.al/biblioteka-online</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion, rezultoi se FHH dhe Departamenti i Historisë, në funksion të programit të studimit “Bachelor në Histori” ka edhe një bibliotekë që shfrytëzohet nga studentët e këtij programi studimi të ciklit të parë, për të studiuar dhe realizuar p.sh. detyra, punimin e</p>

	diplomës, për të studiuar, në përputhje me rregulloren e bibliotekës. (E.3.7; E.3.8; E.3.9)			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se mësimi online zhvillohet në kushtet të mira dhe se stafi i IT-së ka garantuar qasjen në të për pedagogët dhe studentët, përmes përdorimit të platformës Microsoft Teams, si dhe për të lehtësuar përdorimin e saj nga pedagogët dhe studentët, Janë shpërndarë disa manuale për përdorim dhe qasje të platformave online, ku përfshihet edhe informacioni mbi mësimdhënien dhe metodat innovative. (E.2.5; E.2.6; E.2.7; E.2.8).			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Referuar RVB-së, personeli akademik dhe studentët përdorin tashmë komunikimin elektronik përmes platformës Microsoft Teams, për lehtësimin e kontakteve përmes adresave me domenin emër@unitir.edu.al, si një mundësi e mirë për komunikim të brendshëm efektiv, që mundëson edhe komunikim më të shpejtë mes tyre, p.sh për efekt të njoftimeve të ndryshme, notave, vlerësimeve, detyrave, të kontakteve, materialeve mësimore etj. (E.2.5; E.2.8).			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Bazuar në rregulloren e UT, përmbyllja e studimeve realizohet me provim të përgjithshëm përfundimtar. Për hartimin e programit të provimit përfundimtar Departamenti ngre një grup pune Ad-hoc i cili miratohet nga Dekani i FHF. Stafi akademik i angazhuar programin e studimit, mbështet studentët në fushat përkatëse sipas nevojës së studenteve. Detyrimi përmbyllës i programit të studimit Bachelor në Histori përlloritet 8 kredite ECTS. Mbrojtja e diplomës bëhet në dy sezone: sezoni i verës dhe sezoni i vjeshtës. Afatet përcaktohen nga Dekani. Studenti që rrëzohet në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. (E.I.6., neni 15-16)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e	Universiteti i Tiranës në statutin e tij ka përcaktuar Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) për vlerësimin periodik të rezultateve të

<p>vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>veprimtarive mësimore. KPSSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, në kuadër të Universitetit të Tiranës”, në dy aspekte kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit; 2. Vlerësimin e Brendshëm Institucional; <p>Mënyra e funksionimit të sistemit të sigurimit të cilësisë përcaktohet në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni dhe në rregulloret e sigurimit të cilësisë së secilës njësi kryesore. KPSSC bashkëpunon me Dekanët e Fakulteteve dhe me Degën e sigurimit të brendshëm të cilësisë në FHF, për çdo vlerësim të brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të KPSSC shërbejnë si bazë për zyrën e kërkimit shkencor për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik. (E.3.1; E.3.2).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Historisë është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit për cilësinë e mësimdhënies midis personelit akademik dhe studentëve. Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren e vete universitetit. NJSBC harton raportin vjetor të vlerësimit të programit të studimit sipas modelit të miratuar për këtë qëllim në nivel fakulteti, kopje e të cilit i jepet edhe departamentit. Raporti i shërben njësisë bazë për të evidentuar rezultatet e pritshme, pikat e forta dhe pikat e dobëta, për të cilat reflektohet për marrjen e hapave konkrete me qëllim përmirësimin e cilësisë së këtij programi, të mësimdhënies dhe mësimnxënies (E.3.1; E.3.4).</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka një udhëzues strategjik për periudhën 2018-2023 për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në këtë strategji departamenti luan një rol kryesor duke kontribuar në ndërtimin e platformave të reja mësimdhënie. Për shkak edhe të pandemisë, në vitet akademik 2019-2020 (sem II), 2020-2021 u realizua sistemi online i mësimdhënies fale edhe mbështetjes së madhe të stafit të Departamentit dhe specialisteve të IT të UT-së. UT në funksion të cilësisë së programit të studimit ka miratuar “Qendrën virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimit. (E.1.2. - Strategjia e Zhvillimit të UT (2018-2023)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ u informua mbi nivelin aktual të personelit akademik dhe atij mbështetës. Për mësimdhënien</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 32

<p>kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>në PS Bachelor “Histori” në vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar gjithsej si personel akademik 5 Prof.Dr. 6 Prof. Asoc.Dr, 7 Dr. dhe 6 Msc.</p> <p>GVJ konsultoi CV e tyre dhe konkludon që ata kanë arritje të vazhdueshme në fushën e kualifikimit dhe, me angazhimin e tyre në aktivitetet e kërkimit shkencor dhe botimeve, synojnë arritje të mëtejshme çfarë do ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. <i>(Aneks RVB - Tabelat Permbledhese, tab 6.1 -6.3 Bsc ne Histori.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Referuar CV- ve të personelit akademik dhe atij mbështetës konstatohet që UT, FHF dhe Departamenti i Historisë e kanë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme atë, çfarë ka si rezultat edhe titujt e gradat shkencore që ata zotërojnë. Me këtë nivel kualifikimi trupa mësimdhënëse garanton përmirësim të aftësive në procesin mësimor dhe rritjen e mundësisë për implementim e metodave të reja. Institucioni nga ana e tij motivon dhe mbështet trajnimin e stafit në universitete perëndimore në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të UT-së me universitete ndërkombëtare dhe të projekteve, si: Erasmus + KA1 etj.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik i njësisë bazë, përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja. Kjo përfshin përzgjedhjen e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje më të mirë nga stafi me ekspert. Personeli akademik ka realizuar me sukses programin e studimit. Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. <i>(E.1.3, nenet 27-29; E.1.6)</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik azhurnohet në punën e tij lidhur me aplikimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie, duke qenë në koherencë me mundësitë që ofrohen nga teknologjia e informacionit në institucion. Kjo mënyrë e të vepruarit ka nxitur mësimin interaktiv sidomos në drejtim të lehtësimit të mësimdhënies për lëndë të caktuara dhe tematikave specifike. Këta elementë të mësimdhënies që nxisin atraksionin te studentët, janë bërë pjesë dhe e diskutimeve të bëra përmes analizës periodike të departamentit, si pjesë e informacioneve të raportuara prej saj në njësinë kryesore apo në hartimin e raporteve institucionale <i>(E. 1.7; E.3.4).</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 33

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në neniet 8 dhe 9 të rregullores së programit. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Bazuar edhe ne Statutin e UT dhe rregulloren e UT, shkalla e përvetsimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultat i të cilit detyrimisht kthehet në notë. (E. 1.6, neni 8); (E. 1.1); (E. 1.3)
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët, GVJ mësoi që studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Pedagogët e lëndëve iu bëjnë të njohur studentëve që në orën e parë të lëndës, përmbajtjen e syllabus-it, dhe të gjithë informacionin e nevojshëm që ai përmban që në nisje të lëndës. Rregullorja e programit që ata ndjekin parashikon informacionin e duhur për vlerësimin në lëndë dhe format e kontrollit të dijeve. (E. 1.6, neni 8; E.2.1)
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ nga vëzhdimi me kujdes i programeve mësimore të programit të studimit Bachelor në Histori dhe nga kontaktet me studentët, gjykoj dhe konstatoi se kontrolli i dijeve në këtë program studimi realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi final gjithëpërfshirës, si dhe formave të tjera të vlerësimit (detyrë kursi, vlerësim në seminare etj), lidhur me parashikimet e përcaktuara në syllabus-in e lëndës. U vërejt se provimi, është forma kryesore për vlerësimin përfundimtar të njohurive të lëndëve, e cila përcaktohet sipas vlerësimit me shkrim, ose i kombinuar me shkrim e me gojë, e përcaktuar në programin mësimor të secilës lëndë. Studenti përfiton të drejtën për t'u paraqitur në provimin e një lënde, kur ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në planin

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 34

	mësimor dhe në këtë rregullore dhe shlyerja e detyrimeve është e evidentuar nga pedagogu përgjegjës. (E.1.6, neni 8; Aneks RVB – Tabela përmbledhëse).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Në mbështetje të parashtrimit të mësipërm GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma të ndryshme apo alternative (me shkrim, me gojë apo të kombinuara, por edhe përmes detyrave të kursit, kontrolleve të vazhdueshme të dijes gjithë vitit akademik, etj.), duke i krijuar mundësi studentit të shpalosin në to njohuritë dhe kompetencat e fituara. (E.2.1; E.1.5, neni 25; E.1.6, neni 8)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Rweferuar RVB-së, në kushtet e mësimin online për shkak të pandemisë, UT ka implementuar testimin përmes platformës elektronike M. Teams, duke garantuar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm/të shpejtë të vlerësimit për studentët. GVJ konstaton se vlerësimi sipas kësaj platforme është i mundur të përdoret edhe në vijimësi. (E.2.5; E.2.6; E.2.7; E.2.8).
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentit është titullari i lëndës. Në rastet kur lënda ka edhe asistent pedagog, vlerësimi kryhet prej të dy pedagogëve të angazhuar në lëndën përkatëse. Titullari i lëndës harton tezat e provimit, të cilat çdo vit duhet të jenë të riformuluara e të azhurnuara dhe gjithëpërfshirëse, mbështetur në programin mësimor dhe literaturën e parashtruar në të. Në çdo rast, studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga të cilët njëri duhet të jetë i brendshëm. Komisioni përcaktohet nga titullari i lëndës i cili përgjigjet dhe ndjek zhvillimin e provimit.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të	Testimi dhe vlersimi i njohurive e dijeve edhe për këtë program zhvillohet në mënyrë anonime, me sekretim në çdo fund semestri. Sekretimi bëhet nga sekretaria mësimore e cila ruan anonimatin në kushtet e vlersimit nga pedagogu. Pas vlersimit studenti njihet me rezultatin dhe ka të drejtën e


<p>monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>ankimimit sipas dispozitave ligjore të institucionit. Përgjithësisht forma e përdorur për realizimin e testeve në programin e studimit “Bachelor në Histori” është ajo me shkrim. Zhvillimi i provimeve në auditor monitorohet/mbikëqyret nga pedagogu/pedagogët e lëndës.</p> <p>(E.1.3, neni 49-50)</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, në rastet e kontrolleve të vazhdueshme të dijeve, prezantimet e detyrave, angazhimit në projekte, realizim detyrash kurse, duke i këshilluar studentët mbi procesin e të nxënies, lidhur me arritjet dhe mangësitë e tyre, mund të shoqërohet nga pedagogu përkatës me komente, nëse shihet e nevojshme, për të sqaruar studentin, si dhe për ta ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen. Pedagogu mund bëjë konsultime pas provimit, për t’i njohur studentët konkretisht me vlerësimin. (E.1.3, neni.51)</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Referuar RVB-së, rregulloret institucionale dhe rregullorja e programit të studimit të rregullat për zhvillimin e provimeve, temave dhe disertacioneve parashikojnë ndalimin e kopjimit dhe të plagjiaturës. Tek dispozitat mbi standardet etike të sjelljes së studentëve parashikohet ndër të tjera detyrimin e tyre për të respektuar etikën gjatë procesit mësimor, të mos bëjnë tentativa për mashtrim apo cenim të rregullave të procesit akademik, të mos paraqesin punime apo projekte si të tyre, kur kanë dijeni se janë të dikujt tjetër etj. (E.1.6, neni 24-25).</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulët kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sekretaria mësimore e programit, ose mund të merren përmes qasjes në sekretarinë online. Kalimi në platformën online, si për zhvillimin e e mësimin (M. Teams), ashtu edhe të provimeve, krijon më tepër garanci për meritë dhe transparencë në vlerësimin e njohurive dhe dijeve të studentëve të marra në lëndë. (E.1.3, neni 49; E.2.6; E.2.7; E.2.8)</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e universitetit përcaktohet e drejta e studentit për animimin e rezultateve të provimit. GVJ citon nga ky dokument: [...Studentët kanë të drejtë të paraqesin brenda 48 orëve nga marrja dijeni e vlerësimit, ankesë me shkrim tek Përgjegjësi i njësisë bazë DI përkatës me anë të së cilës</p>

	<p><i>kërkojnë të rishikohet vlerësimi i provimit...]</i> GVJ konstaton se në rregulloren e universitetit përcaktohet se ankimimi i studentit i dërgohet përgjegjësit të departamenti i cili në rast të moszgjidhjes se problemit i drejton për zgjidhje Dekanit. Dekani brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. <i>(E.1.3. - Rregullore e UT, neni 51)</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Rregullorja e UT, përkatësisht nenet 50 dhe 51 kane të përcaktuara të gjitha detajet mbi ankimin e vlerësimit. Studenti ka të drejte të ankohet për mos plotësimin e rregullave të provimit dhe të vlerësimit të tij. Kërkesa për ankimi note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UT/FHF. <i>(referuar takimit me stafin akademik dhe studentët)</i> <i>(E. 1.3.; neni 50-51)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Histori synon ta pajisë studentin me njohuri dhe aftësim profesional, me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e historisë, që të bëhen konkurrentë të denjë në tregun e punës. Ky program synon arsimimin dhe formimin e specialistëve të fushës, si dhe synon të krijojë tek ta aftësi interpretuese, analitike dhe zbatuese të përfuara gjatë periudhës së studimit në këtë program, me impakt në vijimin e ciklit të dytë të studimeve apo në sferën profesionale. Stafi akademik i këtij programi në metodologjinë e ndjekur bën një kombinim të metodës tradicionale të mësimdhënies, kombinuar me elementin praktik, me raste studimore, diskutime dhe shqyrtime aktuale, debatet kryesore në fushë, punë në grup etj. <i>(E.1.6,</i></p>

	neni2)
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Histori garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën përkatëse. Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale, analitike e të menduarit kritik në fushë. Gjithashtu ai synon të forcojë komunikimin dhe ndërveprimin mes studentëve si dhe punën në grup. Ky program studimi përkushtohet ndaj vlerave thelbësore të universitetit, si angazhimi intelektual, komuniteti, integriteti, inovacioni dhe gjithëpërfshirja (E.1.6, neni 2; E.2.1).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	GVJ konstaton se në syllabuset e çdo lënde të programit të studimit Bachelor në Histori, studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë dhe rezultatet e të nxënit, ë marrin në lëndën përkatëse. Gjithashtu, jepen njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshëm, në drejtime të tjera studimi, ngushtësisht të lidhura me natyrën e historisë. Të gjitha këto objektiva analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës dhe stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme, si dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat, GVJ konstaton se në përfundim të çdo lënde/moduli, pedagogu mund të bëjë edhe një përmbledhje, ku vë në pah të gjitha çështjet më të rëndësishme që analizohen e shqyrtohen, orienton studentët për zbatimin e tyre, si edhe për detyrimet përmblylëse. Kjo tashmë është një praktikë që zbatohet në lëndët e këtij programi, si rregull në javën e 15 të semestrit që është java e fundit para provimit të lëndës.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton se PAE dhe PAK, i angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Histori”, zbaton mbajtjen e orëve dhe leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, si pjesë të veprimtarive jashtëkurrikulare, siç është, p.sh., edhe trajnimi mbi përdorimin e platformës Teams në kushtet e mësimit online, etj. (E. 1.7). Një ndihmë në këtë drejtim jep krijimi i <i>Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në UT</i> , ngritur me Vendim të Senatit Akademik Nga krijimi i saj, kjo Qendër ka zhvilluar një sërë trajnimesh online me tematika të ndryshme për stafin e UT-së. https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnitimit-dhe-zhvillimit-profesional

<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat, GVJ konstaton se procesi i mësimdhënies në këtë program studimi alternon formimin teorik me aspektin praktik. Me vend vlen të theksohet dhe bashkëpunimi për efekt të zhvillimit të ekspeditave mësimore për studentët e këtij programi studimi. Ekspeditat koordinohen e mbikëqyren nga pedagogë të departamentit. (E.2.1).</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ konstaton se alternimi i metodave të mësimdhënies siguron dhe punën në grup të studentëve, siç janë detyrat e kursit, diskutimi i rastit, etj. Këto forma personeli akademik i përdor në kuadër të angazhimit të studentëve në trajtime rastesh dhe debate interaktive, duke pasur si synim frymën e bashkëpunimit mes tyre, gjithmonë në funksion të realizimit të objektivave të lëndës dhe specifikave të saj (E.2.1).</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat, konstaton se personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore e shkencore. Stafi i këtij programi studimi mbështet dhe asiston studentët në përgatitjen e tyre për aktivitete të tilla studentore, që organizohen çdo vit me qëllim motivimin e tyre dhe zhvillimin e ideve dhe qasjeve origjinale të tyre në fushën e studimit.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni e mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe studimet e avancuara kërkimore e shkencore. Për këtë mund të përmendim veprimtarinë e Forumit Studentor, me titull: <i>“Universiteti në kohën e pandemisë Covid-19: sfida, problematika, zgjidhje”</i> http://ëëë.fhf.edu.al/fhf-botimi-aktet-e-forumit-studentor-universiteti-ne-kohen-e-pandemise-covid-19-sfida-problematika-zgjidhje Pjesëmarrja në këtë aktivitet ishte pa detyrim financiar për studentët, pasi shpenzimet janë mbuluar nga institucioni dhe, po ashtu, edhe botimi i publikimit të akteve të këtij forumi, me referimet e studentëve, janë mbuluar financiarisht nga FHF/UT.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik i ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. UT dhe FHF kanë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera në arsimin e lartë, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të tjerë të sektorit publik, shoqërisë civile, sektorit privat, organizata profesionale, me qëllim</p>

	<p>krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. (E.1.4; E.1.7).</p> <p>Aktualisht UT ka nënshkruar 100 marrëveshje me universitete të tjera në kuadër të Erasmus+ KA107. Për marrëveshjet Erasmus+ KA107 që ka nënshkruar UT me universitete të tjera. https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-kal-te-nenshkuara-nga-universiteti-i-tiranes/</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në rregulloren e përgjithshme të UT është përcaktuar se diplomimi i studenteve në përfundim të ciklit të parë behet me provim formimi. Ngritja e komisionit të provimit është e përcaktuar në rregullore, ai propozohet nga drejtuesi i departamentit dhe miratohet nga Dekani, përbërja është me 5 anëtarë nga departamenti. Për përgatitjen e provimit përfundimtar departamenti ka përcaktuar rregullat dhe mënyrën se si do të zhvillohet. Lëndët dhe temat që studentët duhet të përgatitet u behën të dituar studenteve përgjatë semestrit të VI, departamenti organizon edhe konsultime në varësi të kërkesave të studenteve. Në çdo rast studentët komunikojnë me kujdestaret e grupeve dhe me koordinatoren e programit të studimit. Në takimin me studente u evidentua që mekanizëm kishte funksionuar dhe studentët ishin duke u përgatitur për provimin përfundimtar. (E.1.3. - Rregullore e UT)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Historisë, që mbulon programin e studimit Bachelor në Histori, bashkë me stafin akademik përkatës, ka ndërtuar dhe vënë në dispozicion të studentëve grupin e pyetjeve për provimin përfundimtar, me qëllim informimin dhe udhëzimin e studentëve në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Në fillim të vitit akademik pedagogët njohin studentët me objektivat e tyre për kërkim shkencor, me qëllim që të shfrytëzohen si tema punimi. Çdo student për zgjedh pedagogun udhëheqës, në varësi të interesave që shfaq për të studiuar. Në përfundim të provimit kryetari i komisionit të provimit të diplomës i përcjell sekretarisë së Fakultetit listën e studentëve me vlerësimet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 40

	përkatëse në provimin e diplomës, për të përgatitur diplomat përkatëse. (E.1.6. neni 15-17).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ konstaton se komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Pyetjet për ciklin e parë do të jenë nga lëndët e kurrikulës së programit të studimeve “Bachelor në Histori”. Kryetari i Komisionit të Provimit në bashkëpunim me stafin akademik të grup-lëndëve të programit harton listën e temave të provimit të diplomës e cila u vihet në dispozicion studentëve të paktën 2 muaj para provimit të diplomimit. Tezat përgatiten 1 ditë para provimit nga Komisioni i Provimit dhe firmosen nga Drejtuesi i Departamentit të Historisë dhe anëtarët e Komisionit. Komisioni i Provimit të Diplomës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Çdo anëtar i komisionit jep vlerësimin përkatës për çdo student me pikë, dhe vlerësimi final me notë i studentit bazohet në pikët totale të marra prej tij. (E.1.6, neni 17).
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	GVJ, nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat, konstaton se udhëheqësit e temave të diplomës janë PAE i UT-së, të profilizuar në fusha të caktuara. Për provimin e diplomës Departamenti i historisë harton programin e diplomës me njohuritë më themelore të programit të studimit dhe ja bën të njohur studentëve të vitit të tretë, si edhe e publikon në faqen e vet zyrtare. Departamenti i Historisë përcakton edhe mënyrën e zhvillimit të këtij provimi dhe kriteret e vlerësimit të studentëve. Në rastin e temave të diplomës, që kanë karakter teoriko-aplikativ, personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës, të cilat janë nga fusha e kërkimit shkencor që pedagogu mbulon. Temat e diplomës dhe drejtuesit e tyre miratohen nga Departamenti. (E.1.5, neni 30; E.1.6, nenet 15-17; E.2.9)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ, nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat e paraqitura, konstaton se për përgatitjen e temës së diplomës, logjistika ekzistuese në institucion, siç është biblioteka me sallën e kompjuterëve, mund të aksesohen nga studentët për realizimin e detyrimeve akademike, apo për hedhjen e të dhënave grafike dhe statistikore që mund t'i duhet një studentit për të përgatitur temën e tij të diplomës. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimeve që ka FHF/Departamenti me institucione dhe subjekte të tjerë, u krijon mundësi e lehtësira studentëve në lidhje me hulumtime apo punë në

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 41

	terren dhe arkiva, marrje informacioni të nevojshëm në funksion të temës, realizim pyetësorësh apo anketimi për efekt hulumtimi etj.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ konstaton se udhëheqësit e temave të diplomës orientojnë studentin në lidhje me përgatitjen e temës, në përmbushje të standardeve të miratuara për këtë qëllim. Orientimi i studentit nuk bëhet vetëm në aspektin shkencor por dhe duke pasur në fokus se detyrimet apo përgjegjësinë e tij në lidhje me punimin e diplomës sipas kërkesave e formatit, rregullat e etikës akademike që zbatohen në UT, me qëllim evitimin e plagjiaturës dhe mashtrimin. Punimi pranohet kur prezantohet sipas formatit të kërkuar. Në përfundim të stij dhe para mbrojtjes, udhëheqësi duhet të japë dakordësinë e tij dhe të firmosë temën e diplomës që studenti do mbrojë para komisionit në departament. (E. 1.5, neni 30; E. 1.6, neni 15-17)
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ konstaton se mbrojtja e diplomës bëhet para komisionit të posaçëm të ngritur për këtë qëllim dhe vlerësohet me notë, siç u përshkrua më lart. Kandidati diplomant, i cili rrëzohet në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. (E.1.3, neni 62; E.1.5, neni 30; E.1.6, neni 15-17).
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	GVJ konstaton se studentët që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomë, e cila është një dokument zyrtar, formati i së cilës është miratuar nga MASR. Diploma e Programit të Ciklit të Parë të Studimeve "Bachelor në Histori" shoqërohet me listën e notave dhe me suplementin e diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Diploma firmoset nga Dekani i FHF-së dhe Rektori i UT. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit të Tiranës. Për këtë program të ciklit të parë të studimeve lëshohet diploma: Diplomë Bachelor në "Histori". (E.1.5, neni 61; E.1.6, neni 18; E.3.11).
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ konstaton se në përfundim të këtij programi studimi, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me kërkesën e tij. (E.1.15, neni 63; E.1.6, neni 18; E.3.11).
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas	Sekretaria mësimore e fakultetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mban dhe administron Regjistrin Themeltar (bazë) të studentëve, me të dhënat personale të tyre, si dhe regjistrin e arritjeve akademike, me vlerësimet e

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 42

rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	marra gjatë ndjekjes së programit të studimit. Institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit dhe, kur i kërkohet, paraqet apo konfirmon të dhënat e caktuara që kërkohen për studentin, konformë legjislacionit në fuqi në lidhje me të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Nga vëzhgimet në institucion dhe nga të dhënat e paraqitura në dokumentacion GVJ konstaon se të dhënat mbi rekrutimin e stafit akademik (PAE dhe PAK) apo edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ gjenden të arkivuara dhe administrohen pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme të rektoratit të UT-së. Struktura në fjalë ka përgjegjësinë e mbledhjes, ruajtjes dhe përditësimit të të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program studimit si për të gjitha programet e tjera të studimit. Po ashtu të dhënat mbahen edhe për personelin ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ dhe detyrat që realizon. Sipas nevojave të departamentit, në bashkëpunim me rektoratin, publikohen vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion vakant që më pas i përcillen APP-së për njoftim publik. (E.1.1, Kreu V, seksioni I; E.4.1; E.4.2).
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe	GVJ konstaton se procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten në departament, sipas përcaktimeve statutores dhe të legjislacionit mbi arsimin e lartë. Dekani i FHF-së ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 43




<p>aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>konkurrimit. Shpallja për vende vakante bëhet publike, ku thirrja pasqyrohet dhe në faqen web. Kriteret e punësimit për çdo pozicion vakant i përcillen APP-së për njoftim publik. Për vlerësimin e kandidaturave ngrihet një komision i posaçëm, i cili pasi shqyrton dosjen e kandidatit të paraqitur zhvillon edhe intervistën më gojë. (E.1.1, nenet 65, 67-72)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe duke konsultuar evidencat përkatëse, GVJ konstaton se procedura e rekrutimit të personelit të ri akademik është kryer mbi bazën e nevojave që i paraqiten departamentit të diskutara edhe në mbledhje. Përcaktimi në të bëhet me qëllim që reduktimi i personelit të mbështetet jo vetëm në kriteret e përgjithshme, por edhe në kriteret specifike për pozicionin konkret, mbështetur sipas përcaktimeve që burojnë nga Statuti i UT-së. Kriteret e përcaktuara shpallen dhe bëhen publike. Konkurrimi kryhet përmes një procedure të hapur me qëllim garantimin e një procesi transparent, të paanshëm dhe objektiv. (Statuti i UT)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se rekrutimi i personelit akademik është mbështetur në aktet e brendshme rregullatore përcaktohet dhe bëhet në përputhje me nevojat e departamentit, përmes publikimit të vendeve vakante dhe kërkesave/kritereve të përgjithshme e specifike për plotësimin e tyre. Departamenti, në varësi të strukturës, kualifikimit të stafit dhe programeve të studimit që ofron, përcakton dhe kriteret të veçanta shtesë për vendet vakante, mbështetur mbi kategorinë e personelit që kërkohet të punësohet, të cilat miratohen nga Rektori. Të njëjtat kriteret dhe kërkesa për punësimin e PAE zbatohen edhe për punësimin e PAK.</p> <p>Konkurrimi është i hapur, transparent dhe bëhet sipas një procedure që përcaktohet qartë në statut dhe në rregulloret e brendshme të miratuara. (E.1.1, nenet 67-69; E.1.3, neni 25-26).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke shqyrtuar infrastrukturën ekzistuese në të cilën kryen veprimtarinë e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 44




<p>përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>vet Departamenti i Historisë, konstaton një infrastrukturë të përshtatshme për çdo personel akademik duke siguruar barazi por edhe kushte të mjaftueshme që do të garantonin plotësisht cilësinë dhe performancën në kryerjen e veprimtarisë akademiko-shkencore të çdo anëtari të personelit akademik të Departamentit.</p> <p>FHF, si një nga njësitë kryesore të UT-së, ka kapacitete dhe hapësirë e infrastrukturë të mjaftueshme për programet e studimit që ofrohen nga departamentet e tij. Mjediset ku punojnë pedagogët janë të mira, dhe secili ka hapësirën e vet të punës. (E.3.7: E.1.7)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura, rezulton se Departamenti, në kuadër të strategjisë së zhvillimit të UT, planit të kërkimit shkencor të zhvillimit të UT, planit strategjik të programit të studimit ka krijuar mundësitë që personeli akademik, të kryejë mobilitete për trajnim/mësimdhënie apo dhe kontribute të tjera në kuadër të programeve ERASMUS etj. Gjithashtu sigurohet edhe mbështetje financiare për aktivitete botuese apo referuese në veprimtari shkencore jashtë vendit, sidomos të personelit që aspirojnë titull akademik. Promovimi i stafit për kualifikim të vazhduar dhe mbështetja e tij në aktivitetin kërkimor e hulumtues shprehet në <i>Strategjia e Zhvillimit të UT-së (2018-2023)</i> (E.1.2), (E.1.9), (E.1.10),</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Siç është thënë në kriteret e tjera, komunikimi elektronik nga personeli akademik dhe studentët është tashmë realitet përmes platformës Microsoft Teams. (E.2.5; E.2.8; E.3.7)</p> <p>Nga vizita në institucion, si dhe duke konsultuar evidencat përkatëse, GVJ konstaton se institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. UT zotëron një <i>Qendër Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit</i>. Nga krijimi i saj, kjo Qendër ka zhvilluar një sërë trajnimesh online për stafin e UT-së, me tematika të ndryshme. https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnim-it-dhe-zhvillimit-profesional</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni dëshmon për përpjekje serioze për përmbushjen e objektivave në mbulimin e programit me staf akademik me tituj dhe grada shkencore. Përgjatë vitit 2021-2022 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë:</p> <p>4 Prof. Dr , 5 Prof.Assoc, 5 Dr dhe 1 Msc, ndërsa si lektor me kontrate ka rekrutuar 1 me titull Prof.Dr, 1 Prof.Assoc,</p>

	2 Dr. dhe 5 me Msc. Në lidhje me ngarkesën mësimore dhe shpërndarjen e saj gjatë vitit dhe raportin e kësaj ngarkese respektohen përcaktimet e bëra në Udhëzimin Nr. 29, dt 10.09.2018.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Departamenti i Historisë i cili është përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e programit të studimit, zhvillon procesin mësimor në mjediset e FHF, në godinën kryesore. Në funksion të programit dhe moduleve përkatëse janë biblioteka e FHF dhe biblioteka e dedikuar për këtë program pranë DH. Në këtë të fundit ka tituj librash të specializuar nga autorë të huaj dhe shqiptarë në shërbim të procesit mësimor për studentët e programit.</p> <p>Nga vizita në institucion grupi i GVJ konstaton se mjediset e përshkruara në dokumentacion ishin të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh të cilat plotësojnë realizimin e objektivave mësimorë në funksion të 190 (cikël i plotë) studentëve që ka ky program.</p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion dhe bazuar në evidencat e infrastrukturës reale në dispozicion të procesit mësimor teorik dhe praktik, konstatoi mjaftueshmërinë e hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që sigurojnë kryerjen me efektivitet të llojeve të aktiviteteve mësimore që parashikohen sipas natyrës së moduleve. Njëkohësisht edhe hapësira në dispozicion të personelit akademik është mëse e mjaftueshme qoftë nga pikëpamja fizike ashtu dhe ajo infrastrukturore.</p> <p>Laboratorët e dedikuar për programin e studimit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e</p>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve,	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 46

aftësimet teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	kërkesave të moduleve. Ata kanë akses në internet pa limit dhe në çdo moment mund të lidhen me baza të dhënash hapsinore on-line apo faqe të ndryshme që mundësojnë qasje të ndryshme të nevojshëm për realizimin e detyrave individuale apo projekte. (E. 3.7: Aneks R VB-tabelat përmbledhëse)			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik, çdo ditë të javës nga ora 15.00-20.00. Fakulteti disponon një bibliotekë edhe një sallë leximi me sipërfaqe rreth 82.5 m ² , të pajisur me kompjuterë, ku studentët kanë akses dhe mund ta përdorin atë për përgatitje detyrash, akses në informacion, punë mësimore në funksion të programit të studimit dhe të lëndëve që ndjekin. (Aneks RVB - tabelat përmbledhëse)			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në nivel universiteti, UT vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Universitare në Rektorat dhe bibliotekën pranë FHF. Biblioteka e FHF garanton të drejtën e çdo studenti për, aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambjenteve të mjediseve të brendëshme dhe të jashtëme të saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i të gjithë hapsirës së bibliotekës me rrjetin Wireless dhe të aksesohen në biblioteka on-line.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista	Nga vizita në institucion GVJ konstaton se biblioteka e FHF është e pajisur me : <ul style="list-style-type: none"> • Libra në hard copy (të printuar), Periodikë, CD & tituj e harta - 165.000; • Tituj në gjuhën shqipe: rreth 70% e fondit;


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 47

<p>shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Tituj në gjuhë të huaj: rreth 30% e fondit; • Periodikë total: përafërsisht 100.000; <p>Periodikë në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht): 67 tituj Po ashtu, në dispozicion të studentëve. por edhe të stafit, janë edhe bibliotekat online, si: JSTOR. Si pjesë e marrëveshjes së UT-së me AADF). Biblioteka është pasuruar kohë mbas kohe me botime të reja, përfshirë edhe fushën e historisë. (E.3.7; E.3.8).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UT ka vënë në dispozicion të studentëve edhe bibliotekat online, pa pagesë si: JSTOR (pjesë e marrëveshjes së UT-së me AADF), COBISS+, etj. Në UT funksionon biblioteka online e universitetit, ku çdo student mund të aksesojë informacionin e nevojshëm: https://unitir.edu.al/biblioteka-online Për lehtësimin e përdorimit të librarisë digjitale, RASH ka hartuar edhe një manual për përdorimin si dhe linkun për aksesimin e saj, https://ulibrary.rash.al/ https://unitir.edu.al/biblioteka-online/ (E.3.7; E.3.8)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se Biblioteka e Fakultetit ka në funksion të saj dhe një sallë interneti/leximi e pajisur me kompjuterë dhe programe kompjuterike si dhe pajisje të tjera, të cilat përdoren nga të gjithë frekuentuesit e saj, pa kufizime, në përputhje me rregulloren e saj. Për studentët dhe stafin aksesimi dhe punë në Bibliotetë është pa pagesë, por dhe infrastruktura teknologjike e saj gjatë orarit zyrtar, në përputhje me Rregulloren e kësaj biblioteke. Studentët dhe personelin akademik me kohë të plotë të FHF-së mundësohen në këtë bibliotekë të kenë akses të lirë me një kohëzgjatje të përcaktuar, mbështetur në rregulloren e saj. (E.3.9).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>FHF ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vinë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga personeli akademik me titujt e propozuar i përcjellin ato bibliotekës së FHF. Nga takimi që patëm me punonjësen e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e stafit akademik dhe realizimi i procedurës për pasurimin e fondit realizohet në mënyrë periodike.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-16.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 48

mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	të tërheqin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shrytëzonin bibliotekën gjatë hapsirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj. (E.3.9).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB-së, GVJ konstaton se institucioni zotëron një sistem menaxhimi përmes të cilit administrohen të gjithë informacionet që kanë të bëjnë me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga hyrja/regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, informacion që mbahet në bazën përkatëse të të dhënave. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit, si dhe shërben për të nxjerrë edhe statistika (E.4.3). <i>GVJ sugjeron që Sekretaria mësimore, duhet të jetë në koherencë dhe me udhëzimet e paraqitura lidhur me risitë e mbajtjes së të dhënave të studentëve që nga hyrja e deri në dalje të tyre.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstaton se informacioni që lidhet me veprimtarinë dhe performancën akademike administrohet nga sistemi i brendshëm i menaxhimit. Kjo e fundit i takon njësisë bazë - departamentit. Bashkë me këtë informacion mbahen edhe të dhëna lidhur me stafin akademik që angazhohet çdo semestër në këtë program studimi, me lëndën/lëndët përkatëse që mbulon dhe ngarkesën e planifikuar dhe të realizuar nga departamenti për programin e studimit Bachelor në Histori. Ky informacion bëhet edhe pjesë e analizave dhe raporteve në nivel njësie apo institucioni. (E.1.7; E.4.2)
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ evidenton se sistemi i menaxhimit të FHF-së dhe departamentit të Historisë siguron akses të dedikuar si për stafin, ashtu dhe për studentët, duke dhënë garancitë e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave personale, në mbështetje të detyrimeve që burojnë nga ligji respektiv në fuqi (Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale). Lidhur me

	informinin e studentëve, mbajtjen e të dhënave personale, dhe koordinimin e procesit mësimor apo aktiviteteve të tjera në funksion të tij, rol të rëndësishëm luajnë si sekretaria mësimore ashtu dhe departamenti.
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit e mundëson aksesin nëpërmjet llogarive personale të stafit dhe studentëve në domen emër@unitir.edu.al. Të gjithë anëtarët e personelit akademik, ndihmëskademik dhe sekretaria mësimore kanë akses në llogarinë e tyre personale. Studentët në profile personale dhe me qasje personale, kanë portalin e vet elektronik, përmes të cilit: mund të regjistrohet në kurset që do të frekuentojë, të verifikojë konfidencialisht arritjet e tij akademike. Përmes faqes zyrtare studentët mund kërkojnë të printojnë fatura në lidhje me tarifat e studimit, vërtetim studentit, listë notash, certifikatë notash, programi studimi shqip dhe anglisht, etj. (E.1.3, nenet 42, 68-70; E.4.3).</p> <p>Komunikimi me anë të postës elektronike me emër domeni unitir.edu.al apo formave alternative të vendosura në dispozicion nga UT bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e UT-së, rregulloret e brendshme dhe Kodin e Etikës.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ konstaton se sistemi të brendshëm siguron dhe garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Në kohë reale dhe përmjet sistemit të menaxhimit, llogarive personale të stafit dhe studentëve, platformës digjitale MS Teams, faqes zyrtare të UT-së (www.unitir.edu.al) dhe FHF-së (www.fhf.edu.al) garantohej aktiviteti akademik dhe administrativ. Të dhëna mbi funksionin, dokumentacionin e zyrave/strukturave të ndryshme, përpunohen dhe reflektohen edhe në raporte të ndryshme që hartohen për autoritetet dhe organet më të larta drejtuese të fakultetit, universitetit, apo edhe raportime institucionale. (E. 1.7)</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga kontaktet me studentët dhe takimet me personelin akademik të departamentit të Historisë në FHF rezultoi se informacionet që lidhen me programin e studimit bachelor në Histori, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme mësimor dhe esktrakurrikular, të organizuara në këtë departament, aktet e brendshme rregullatore, etj, janë publikuar në faqen e internetit të UT-së dhe FHF-së. Materialet e publikuara janë të plota, dhe përcjellin informacion të bollshëm mbi aktivitetin e UT-së dhe FHF-së, të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit dhe ofrohen në gjuhën shqipe, si gjuhë kryesore. Gjithashtu,</p>

	informacione në rubrika të caktuara janë të vlefshme edhe në anglisht. www.unitir.edu.al ; www.fhf.edu.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga buxheti i UT, ku pasqyrohen edhe të ardhurat e shpenzimet për çdo njësi të tij, FHF-së i akordohet buxheti i saj në raport me nevojat, bazuar në buxhetin afatmesëm të tij 3-vjeçar. Fakulteti në bashkëpunim me departamentet dhe nevojat e tyre harton çdo vit akademik planbuxhetin e tij në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit që ai ofron. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, me qëllim arritjen e objektivave strategjike, si dhe realizimin e misionit të saj. (E.4.4)
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	GVJ konstaton se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, si dhe bëhet një vlerësim i ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kostot për çdo program studimi, pasi kostoja ndryshon nga një program studimi në tjetrin. Struktura e programit financiar bëhet duke i ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet sipas drejtimeve ku ato do të përdoren. Burimet financiare të institucionit hartohen duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të UT, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre. (E.2- Statuti i UT-së, neni 55, pika h);E.4.4).
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton	Referuar RVB-sëUT kryen një auditim të përvitshëm të brendshëm dhe të jashtëm mbi situatën financiare. Në nivel

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Page 51

<p>gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>të brendshëm, UT ka ngritur në strukturën e tij Sektorin e Auditit të Brendshëm, i cili është nën varësinë e Bordit të Administrimit, i cili monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit nëpërmjet auditimit të brendshëm. (E. 1.1, neni 55/11 dhe neni 57).</p> <p>Raportet financiare të paraqitura në kuadër të programit të transparencës përmbajnë tabelat për të ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare të detajuara. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve. Financimi dhe të ardhurat për FHF janë pjesë e informacionit dhe të dhënave financiare të UT-së. (E.4.4).</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se UT ka të dokumentuar raportet financiare, për secilin vit akademik (për vitet e përfshira në akreditim), proces ky që fillon në çdo vit, në periudhën mars-maj. Në fund raporti miratohet nga Bordi i Administrimit dhe aty parashikohen edhe ndërhyrjet e mundshme dhe eventuale të financimit të programeve të caktuara të studimit, në përputhje me kompetencat e tija Statutore. (E.1.1, neni 55).</p> <p>Planifikimet dhe ndërhyrjet e posaçme parashikohen në buxhetin afatmesëm për garantimin dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. (E.4.4).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni dëshmon garanci mbi qëndrueshmërinë financiare dhe kapacitete financiare për vijimin e aktivitetit akademik dhe kërkimor-shkencor të tij. Parashikimi i mënyrës së përdorimit të fondeve parashikohet në buxhetin afatmesëm dhe atë të vitit fiskal të UT-së. Burimet e buxhetit të UT-së krijohen nga burime të përcaktuara që realizohen në përputhje me rregulla ligjore të detyrueshme përgjithësisht në entet publike duke ruajtur autonominë në përdorimin e të ardhurave.</p> <p>UT-ja financohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) buxheti i shtetit; b) pagesat e studentëve për arsimim; c) të ardhurat për shërbimet e kryera; ç) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; d) donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; dh) veprimtari kërkimor-shkencor; e) projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare <p>Të gjitha të ardhurat e krijuara nga Universiteti përdoren prej tij dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës (E. 1.1, neni 143-144).</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Parë të studimeve “Bachelor në Histori”, në FHF, realizohet bazuar në legjislacionin në fuqi, në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në kriteret e parashikuara në Rregulloren e UT, si dhe në kriteret dhe kuotat e propozuara nga njësiti bazë dhe të miratuara nga senati akademik i Universitetit të Tiranës. Ai garanton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë, si dhe për studentët e këtij program studimi. Të drejtat dhe detyrat e studentëve parashikohen në Statutin dhe Rregulloren e UT-së, si dhe në Rregulloren e këtij programi studimi. (E.1.1, Kreu IX; E.1.3, Kreu IV; E.1.6, neni 20-23).</p> <p>UT-ja mundëson dhe ndjekjen e programeve të ciklit të parë dhe për personat që transferojnë studimet, përmes njohjes së krediteve të mëparshme të tyre. E njëjta procedurë ndiqet dhe për personat që duan të ndjekin një program të dytë studimi, si dhe për shtetas të huaj. (E 1.1, Kreu VII; E.1.6, nenet 3-6; E.5.3)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat, rezulton se programi i studimit bachelor në Histori është hartuar dhe zbatuar duke u bazuar në lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve bazuar në legjislacionin në fuqi. Për kandidatët e interesuar për vijimësi të programeve të studimit, si edhe për studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Histori procedurat dhe politikat e ndjekura nga hyrja në dalje të studentëve</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 53

	<p>garantime barazinë, gjë e cila pasqyrohet në të gjitha aktet rregullatore të UT. Kuotat dhe kriteret e pranimit miratohen sipas procedurave ligjore dhe ato janë të shpallura publikisht e janë të aksesueshme nga të gjithë. Informacioni publikohet më faqen zyrtare të UT-së dhe atë të FHF-së. (E.1.6; E.5.3; E.5.4).</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se objektivat e programit të studimit bachelor në Histori janë të janë të përcaktuara qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e objektivave institucionalë. Kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit, struktura e vitit akademik etj., përcaktohen në Rregulloren e këtij programi dhe janë të kuptueshme për publikun. Kriteret dhe kuotat e pranimit, kanë mënyrën e tyre të llogaritjes, e cila është bërë edhe publike. (E.5.3)</p> <p>Llogaritja për efekt të përzgjedhjes së fituesve në Bachelor për vitin akademik është bërë në bazë të kriterëve të përcaktuara qartë dhe të shpallura në linkun përkatës: www.fhf.edu.al/fhf-kriteret-e-pranimit-per-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-per-vitin-akademik-2022-2023/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi është kryer nëpërmjet aplikimit nga kandidatët që kanë shfaqur interes, mbështetur në kriteret e vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. Në çdo fillim viti akademik, UT vë në dispozicion informacion të nevojshëm për: studentët lidhur me pranimin e tyre, mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, mundësitë për transferime kreditesh, etj. Renditja e kandidatëve fitues për programin bachelor, bëhet nga FHF-ja përmes shpalljes së listës përpara fillimit të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Në përputhje me: standartet e kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në RSH, aktet e brendshme rregullatore të UT-së, mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe në bazë të kuotave të miratuara nga Senati Akademik për një vit akademik kryhet dhe numri i pranimeve.</p> <p>Departamentet në FHF, përfshirë edhe departamentin e historisë, propozojnë kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 10 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik, për të gjitha programet e studimit që ofron. Një procedurë e tillë bëhet në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë. Të gjitha të dhënat më pas bëhen publike (FHF). Kriteret i përcillen rektoratit, i cili ka për detyrë t'ia përcjellë MASR. Në këto kriteret përfshihen dhe ato për shtetasit e huaj, për kategori të</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me: standartet e kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në RSH, aktet e brendshme rregullatore të UT-së, mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe në bazë të kuotave të miratuara nga Senati Akademik për një vit akademik kryhet dhe numri i pranimeve.</p> <p>Departamentet në FHF, përfshirë edhe departamentin e historisë, propozojnë kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 10 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik, për të gjitha programet e studimit që ofron. Një procedurë e tillë bëhet në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë. Të gjitha të dhënat më pas bëhen publike (FHF). Kriteret i përcillen rektoratit, i cili ka për detyrë t'ia përcjellë MASR. Në këto kriteret përfshihen dhe ato për shtetasit e huaj, për kategori të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 54

	caktuara, uljet e tarifave, bursat dhe kush i përfiton etj. (E.1.1, neni 94) https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimet-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit		
	https://ëëë.fhf.edu.al/fhf-kriteret-e-pranimet-per-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-per-vitin-akademik-2022-2023/ https://ëëë.fhf.edu.al/fillojne-aplikimet-per-burse-per-vitin-akademik-2019-2020/		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga vizita në Institucion del që Departamenti i Historisë ofron informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Ky informacion gjendet i pasqyruar në rregulloren e programit të studimit i cili është dhe i publikuar në faqen web. Gjithashtu, ky informacion jepet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet javës orientuese në fillim të studimeve. Informacioni jepet edhe nëpërmjet vetë personelit akademik për çdo disiplinë bazuar tek syllabusi i saj apo dhe nga Kujdestari Akademik i çdo viti që caktohet çdo fillim viti akademik për çdo vit studimi. Njëkohësisht, këto informacione që studenti i merr drejtpërsëdrejti apo dhe të tjera shtesë që lidhen dhe me infrastrukturën e FHF, studenti mund ti marrë edhe nëpërmjet faqes web të FHF dhe Departamentit. (E.1.6;)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në bazë të evidencave të paraqitura, rezulton që ekziston një procedurë e lidhur me kriteret dhe procedurat e transferimeve të studentëve dhe ekuivalentimeve të mundshme pas transferimit. I gjithë ky informacion gjendet në Statutin dhe Rregulloren e UT. Duke u mbështetur në këto dokumente ligjore, Departamenti i Historisë disponon një procedurë transparente dhe rigorozë për njohjen e studimeve të mëparshme. (E.1.1); (E.1.3);
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive	Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë si nga personeli akademik përkatës ashtu edhe nga Kujdestari Akademik në mënyrë të drejtpërdrejtë, por këtë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 55

<p>të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>informacion ata mund ta marrin edhe nga Rregullorja e UT apo e Programit të studimit, apo syllabuset e disiplinave që gjendet në faqen web. Informohen në afatet e duhura në ambiente publike lidhur me kohën dhe oraret e provimeve. Për të vlerësuar studentin me pikë, përdoren kryesisht aktivizimi dhe frekuentimi në auditor, testimi me shkrim apo dhe me gojë. Pikët konvertohen në notë mbi bazën e intervaleve plotësisht të përcaktuara në syllabusin e lëndëve. Studentit i jepet mundësia të njihet me testin që ka shkruar, me pikët e çdo elementi në vlerësim dhe gjithashtu ka dhe të drejtën e ankimit në rast se lind nevoja në afatet kohore dhe me mënyrën e përcaktuar në Rregullore. (E.1.3)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rezulton që studentët e vitit të tretë informohen që në fillim të vitit akademik dhe gjatë tij, nga Kujdestari Akademik dhe sekretaria mësimore për rregullat dhe programin e diplomimit. Gjithashtu ky informacion merret edhe nëpërmjet Statutit dhe Rregullores së UT, Rregulloren e programit të Studimit si dhe ekziston dhe Rregullorja e Diplomimit. Departamenti, edhe nëpërmjet kujdestarit akademik të studentëve, i informon ata rreth procedurës dhe llojit të provimit të formimit të parashikuar. Informacion që gjendet edhe në rregulloren e vet programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni, në rang universiteti, por edhe njësie kryesore dhe në ato bazë, publikon udhëzues të posaçëm, si broshura dhe fletëpalosje mbi kriteret e pranimit dhe informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara nga Universiteti i Tiranës, dhe në veçanti ato të ofruara në FHF. Njëkohësisht, Universiteti i Tiranës, FHF, në bashkëpunim me drejtoritë vendore rajonale të arsimit para-universitar, dhe përfaqësues të departamentit të Informatikës, organizojnë takime me maurantët në shkollat e mesme kryesisht në periudhën Mars-Maj, që është periudha para plotësimit të formularëve të aplikimit të maurantëve. Kjo gjë bëhet edhe në panairin e universiteteve apo Ditët e hapura të informimit të maurantëve të organizuara në rrethe të ndryshme.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Rezulton që studentët informohen që në javën e parë të vitit akademik në javën orientuese në mënyrë të hollësishme lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Këtë informacion e marrin edhe në vijim të vitit nëpërmjet Kujdestarit Akademik, zyra e këshillimit dhe karrierës edhe nga secili personel akademik. Njëkohësisht këtë informacion ata mund ta marrin edhe nga faqja web e FHF dhe e Departamentit, ku ata mund të njihen gjithashtu edhe për infrastrukturën e ambienteve dhe shërbimet që merren prej tyre. Në mbështetje të studentëve për informacion është dhe sekretaria mësimore dhe dega e IT së FHF. GVJ konstatoi nga biseda me ta, që studentët ishin të informuar për këto elemente. (E.5.2).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se departamenti në çdo fillim viti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit jep informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj. Syllabuset janë të vlefshme për studentët në hard copy por edhe elektronikisht dhe përmbajnë literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar si dhe elementë të nevojshëm për lëndën dhe detyrimet akademike që lidhen me të. Përdorimi i platformës M. Teams ka sjellë lehtësira në këtë komunikim dhe shkëmbim informacioni të shpejtë. (E.2.1; E.5.2; E.2.5; E.2.6; E.2.7)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve me qëllim motivimin personal dhe orientimin sa më të mirë në tregun e punës, u përcillet informacion periodik lidhur me mundësitë për trajnime, pjesëmarrje në programe shkëmbimi për studentë, mundësi internship-i dhe letër rekomandimi për mbështetje ndaj tyre, etj. Në lidhje me qartësimin dhe njohjen e objektivave të secilit prej programeve master që ofron dhe mundësitë/avantazhet e këtyre programeve për karrierën e tyre profesionale dhe orientimin më të mirë në tregun e punës në punën e tij Departamenti ndjek politika në funksion të mbështetjes dhe orientimit të studentëve në këto aspekte, e cila zhvillohet sidomos dhe gjatë javës së orientimit, por edhe në vijim për efekt të këshillimit të karrierës. (E.1.4; E.3.4) https://ëëë.unitir.edu.al/thirrje-e-hapur-per-student</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve u vihet në dispozicion informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe</p>

<p>procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>shërbimet në funksion të realizimit të tij, përmes ditëve të informimit dhe orientimit për studentët e rinj, por edhe përmes udhërrëfyesit informativ mbi programet e studimit në FHF, fletëpalosjes informative, informacionit online që publikon FHF në faqen e vet, si dhe nga departamenti përmes njoftimeve apo informimeve të ndryshme gjatë vitit akademik, gjithnjë në funksion të realizimit të procesit mësimor. (E.3.7; E.5.2).</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Përmes mënyrave të ndryshme përfshi dhe qasjen online, në ëebfaqen e fakultetit, përmes Portalit të studentit, përcillen informacione të plota në lidhje me këtë program studimi. Kjo mënyrë e të proceduarit mundëson një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe platforma Teams, synon lehtësimin e marrjes së informacioneve edhe nga studentët në distancë. Informacioni që përcillet është lehtësisht i arritshëm dhe i ndihmon studentët që të informohen në kohë të duhur në lidhje me programin e studimit dhe detyrimet akademike të studentëve në tërësi. Çdo student ka adresën e tij të e-mailit, ku logohet në domen me emrin e tij @unitir.edu.al (E.2.5) https://ëëë.fhf.edu.al/studentet</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Gjithë baza e të dhënave dhe statistikat përkatëse lidhur me studentet deri në diplomim, administrohen nga Sekretaria mësimore për të gjitha vitet. Dokumentacioni bazë konsiston në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomës. Këto të dhëna arkivohen mbi bazën e ligjit mbi arkivimin e dokumentacionit zyrtar. Sekretaria mësimore administron të gjithë dokumentacionin për çdo student të regjistruar të çregjistruar, të transferuar, të diplomuar, në program të dytë studimi, gjithë vlerësimet akademike të tyre, dhe mbi bazën e të cilave prodhohen statistikat apo dokumentacionet zyrtare për studentin, institucionin apo</p>

	<p>MAS.</p> <p>Mbështetur në <i>(Aneks RVB - Tabelat Permbledhese, Bsc ne Histori., tab 21)</i> dhe vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve për tre vite akademike është:</p> <p>2019-2020 94 studentë;</p> <p>2020-2021 47 studentë;</p> <p>2021-2022 49 studentë;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore administron regjistrin themeltar të çdo studenti ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar gjithë arritjet akademike të tij, në çdo vit duke respektuar dhe duke u bazuar rregulloren e UT dhe rregulloren e programit të studimit. Detyrime si frekuentimi, zhvillimi i laboratorëve apo i detyrave/projekteve të kursit, detyrime të cilat janë parakusht për lejimin në provim, administrohen vetëm nga pedagogu i lëndës. <i>(E.1.7; E.4.3)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga kontrolli në sekretarinë mësimore i regjistrin themeltar, në regjistrin e rezultateve akademike të studentit, si dhe në Regjistrin e Diplomave, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve janë të pasqyruara në to. Këto të dhëna janë edhe në databazat përkatëse. Sekretaria mësimore administron të dhënat e studentëve për programin e studimit. Informacioni ruhet në databazat e sekretarisë (sistemi i brendshëm). Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në proces-verbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve. Studentët lehtësisht mund të njihen me vlerësimet që lëndë përmes aksesit nëpërmjet aksesit në portal duke loguar në të. <i>(E.4.3)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësisë të tyre, duke e shoqëruar me masat e</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni harton raporte analitike periodike (vjetore) që plotësohen sipas një formati që vjen nga rektorati. Përmes tij jepen të dhëna sasiore dhe cilësore që lidhen me veprimtarinë e departamentit, performancën, të dhëna mbi studentët, aktivitetet dhe veprimtaria shkencore, ngarkesa mësimore e pedagogëve, publikimet,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 59

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	bashkëpunimet dhe partneritetet, etj. Në funksion të hartimit të raporteve analitike mund të hartohen edhe analiza të tjera, p.sh., analizë e tregut të punës, etj. Përmes të dhënave nga të pasqyruara në raportet analitike kryhet dhe vlerësimi i performancës dhe identifikimi i nevojave, në funksion të përmirësimit të punës dhe arritjeve në drejtim të realizimit të objektivave formues të programit të studimit. (E.1.7; E.3.4; E.5.1).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në zbatim të Ligjit të arsimit të lartë dhe Rregullores dhe Statutit të UT, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale si: Senati Akademik, Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, Këshilli i etikës. Gjithashtu studentët marrin pjesë në grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësimin e programeve të studimit dhe vlerësimin institucional. Studentët janë dhe pjesë e vlerësimit të mësimdhënies dhe personelit akademik, nëpërmjet pyetësorëve që organizohen periodikisht me ta. (E. 1.1, neni 84-85; E. 1.6, neni 20)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se UT garanton përfshirje të studentëve përmes përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, kryesisht në përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale, në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike, përmes pyetësorëve. Përfshirja reale e studentëve përmes përfaqësimit studentor në forume apo organizime studentore synon përcjelljen e zërit të studentëve, në këshillim karriere etj. Këto të drejta përfaqësimi përcaktohen qartësisht në Rregulloren së UT (E. 1.6, nenet 84-85), si edhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Histori.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve	GVJ konstaton se institucioni merr në konsideratë në punën e tij përmirësimin e programeve të studimit përmes hartimit

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 60

<p>të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>apo ndryshimeve e mundshme të programit, ngarkesën e studentëve brenda dhe jashtë auditorit, nëpërmjet shpërndarjes së kësaj ngarkese mes punës në auditor dhe jashtë tij për secilën lëndë, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. E parashikuar në aktet e brendshme rregullatore është dhe: njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përfuara në një IAL tjetër, mundësimi i njohjes së plotë dhe të pjesshme të krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose jashtë universitetit. (E.1.1, nenet 78-82; E.1.6, neni 6).</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve si pjesë e komisioneve/organeve kolegiale, përmes të cilave ata kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, të përmirësimit të performancës dhe cilësisë së programit, duke dhënë kështu kontributin e tyre me vlerë në të gjitha këto organe kolegiale ku bëjnë pjesë. Si pjesë e rëndësishme e raporteve që hartohen nga NJSBC luajnë dhe merren dhe sugjerimet dhe kontributet e studentëve në nivel departamenti, në mënyrë të drejtpërdrejtë, për programin konkret të studimit që ata ndjekin. Këto sugjerime dhe kontribute u shërbejnë më tej njësive bazë për analiza dhe për të adresuar problematikat e hasura. (E.1.1, neni 141; E.3.4; E.3.5)</p>		
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësive/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu/ët i/e lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, siç është vlerësimi i provimit të lëndës, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi/ese, etj. Studentëve u mundësohet si një e drejtë e tyre njohja me: procedurën e zhvillimit të kontrollit të dijeve, tezën e provimit pas korrigjimit dhe mënyrën e vlerësimit (njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë) si dhe të drejtën e ankimimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit dhe rezultatin e tij përfundimtar. (E.1.3, nenet 50-51; E.4.3)</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Bazuar tek dokumentet kryesore zyrtare ligjore të UT: Rregullore, Statut, Rregullore e programit të studimit etj. funksionojnë disa njësi të posaçme me kompetenca të përcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve si: zyra IT, Njësia bazë, Kujdestari akademik, Dega e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës, Këshilli studentor, Biblioteka e FSHN, Sekretaria Mësimore. Nga biseda e GVJ me studentët rezultoi që të gjitha këto njësi janë funksionale, ku secila prej tyre informon studentët brenda fushës së vet të kompetencës. (E.1.; E.3.2; E.3.4).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se departamenti, ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme akademike të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët, si dhe mbështetjen e konsultimit që ofrohet nga pedagogët e departamentit në lidhje me diplomimin në përfundim të këtij cikli përmes koordinatorit dhe stafit akademik të tij. Në ndihmë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në ndihmë ofrohet dhe nga ana e stafit ndihmës-akademik dhe administrativ, me qëllim lehtësimin dhe informimin e tyre në kohë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se zyra e këshillimit të karrierës jep informacion të vlefshëm në lidhje me studentët në këtë program studimi, duke i informuar studentët sa u përket institucioneve me të cilat fakulteti/departamenti ka marrëveshje, mundësi internship-i etj. Nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të vazhdueshme, studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit. Studentët asistohen për këtë qëllim dhe marrin informacionin e nevojshëm që i vlen atyre për t'u orientuar dhe projektuar më mirë në tregun e punës si dhe në vijimin e shkollimit të tyre në programet e ciklit të dytë të studimeve. (E.1.7; E.3.4)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të</p>	<p>GVJ konstaton se departamenti mban lidhje me të diplomuarit në nivelin Bachelor dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre vijojnë studimet në programet e ciklit të dytë që ofron departamenti i historisë. Mbledhja e të dhënave për të diplomuarit në këtë program studimi nga</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 62

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	ana e Departamentit, është përfshirë dhe në një raport të fundit të tij. Gjurmimi i të diplomuarve në vitin akademik 2020-2021 në nivelin Bachelor, pranë Departamentit të Historisë është kryer bazuar në zbatimin e Strategjisë së zhvillimit të UT-së 2018- 2023, në vitin 2021. Këto të dhëna bëhen pjesë edhe e raporteve vjetore të departamentit dhe u përcillen organeve/autoriteteve drejtuese të fakultetit/universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton që UT në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare Statut etj, ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë. Është miratuar Manuali i Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohen qartë parimet dhe procedurat për zbatimin e tij. Janë ngritur strukturat në rang universiteti siç janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës etj. funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të tyre janë të përcaktuara në Statutin e UT. Gjithashtu, në vijim janë ngritur strukturat në rang njësie kryesore, siç është Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC apo DSBCK), e cila ndër të tjerash në bashkëpunim me Zv. Dekanin përkatës që mbulon Ciklin e parë dhe të Dytë të studimeve, organizon pyetësorët me studentët për cilësinë e mësimdhënies për disipinat e

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 63

	<p>programit të studimit, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. NJSBC harton raportet e vlerësimeve. (E. 1.1, Neni 41 dhe Kreu X) . (E. 3.1)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, konstaton se UT e ka tashmë të ngritur dhe funksional Sistemin e tij të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Si strukturë përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit (E.3.1, neni 15) është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), me funksionet e organit kolegjal që shtrin veprimtarinë e tij në nivel institucioni. Sigurimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në FHF (E.1.1, Neni 41 dhe Kreu X; (E.3.3). Në veprimtarinë dhe punën e tij Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë mbështetet në garantimin e pjesëmarrjes së personelit akademik dhe të studentëve në procesin e vetëvlerësimit dhe në përfitimin prej ekspertizës së jashtme për sigurimin e cilësisë (E. 1.1, neni 139/dh; E. 3.3, E.3.4)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni përdor instrumentet e duhura përmes së cilës vlerëson në mënyrë periodike standardet e cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. (E.3.3; E.3.4). UT e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe ekspertë në këto procese përmes adoptimit të politikave dhe standardeve për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Nga vizita e GVJ në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur evidentohet se Institucioni ka planifikuar dhe organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen procesit të akreditimit, në mënyrë periodike. (E.3.3, Kreu II).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang</p>	<p>GVJ konstaton se në UT ndërmeren politika për sigurimin e cilësisë, është ngritur dhe funksionon sistemi i menaxhimit dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe në nivel të njësive kryesore; kryehen herë pas here veprimtari monitoruese, vlerësuese dhe përmirësuese.</p> <p>Në politikat e ndjekura për sigurimin e cilësisë si proces përfshihen: rishikimin, përditësimin e parimeve, të standardeve, të treguesve, përmirësimin e sistemit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 64

institucional, të njëjive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimin dhe përmirësimin e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit. (E.3.3, neni 5/8 dhe neni 10).			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>GVJ konstaton se programet e studimit që ofrohen nga departamenti, rishikohen në nivel të brendshëm të kësaj njësie, për t'i përshtatur ato me nevojat specifike të këtij programi studimi dhe me nevojat e tregut të punës në mënyrë të herëpashershme. (E.2.4)</p> <p>Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) përmes strukturave në nivel institucioni monitoron dhe vlerëson periodikisht programet.</p> <p>Gjatë takimeve u konfirmua nga anëtarët e njësisë se vlerësimet e marra përmes strukturave ndikojnë në përmirësim të vazhdueshëm të programeve të studimit. Drejtoria e Kurrikulave dhe e Sigurimit të Cilësisë, që funksionon në Rektorat (në nivel institucional) ka për detyrë të mbulojë aspektet akademike, të programeve, kurrikulave dhe ato të sigurimit të cilësisë në Universitetin e Tiranës, në zbatimin të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Statutit të UT-së dhe rregulloreve të institucionit. (E.3.1, neni 7, Standardi 9, neni 30 2; E.3.4); (E.6.1, neni 11 dhe shtojca përkatëse).</p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>GVJ konstaton se syllabus-et rishikohen në fillim të vitit akademik, në nivel departamenti nga pedagogët përkatës. Bashkë me syllabus-et, nëse gjykohet e nevojshme mund të rishihet edhe kurrikula për programin e studimit brenda masës 20 % të tij. Ky informacion dokumentohet dhe i dërgohet zyrtarisht në formë shkresore, Rektoratit të UT (Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë) dhe më pas për t'u shqyrtuar nga Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës si struktura përgjegjëse për vlerësimin e projektprogrameve të paraqitura. (E.1.1, neni 105; E.2.4; E.3.4; E.3.5)</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 65

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

Për matjen e cilësisë ndër instrumentet e parashikuara nga institucioni janë: pyetësorë dhe vlerësime të studentëve; Fokus grupe me studentët; raporte vetëvlerësimi nga pedagogët; formular i veprimtarisë kërkimore-shkencore për secilin pedagog; formular vlerësimi nga personeli akademik; Raportet vjetore të departamentit etj. (E.3.2; E.1.7; E.3.4). *GVJ gjatë vizitës u njoh me këto dokumenta.* UT harton raportin e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore mbi analizën e programeve të studimit, ku përfshihet edhe ky program studimi që po akreditohet në përfundim të çdo viti akademik.

Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

Një ndër dokumentet bazë dhe të rëndësishëm që prodhohen nga mekanizmat e sigurimi të cilësisë, është raporti i veprimtarisë mësimore-kërkimore të njësisë bazë, i cili hartohet dhe merret në analizë në fund të vitit akademik, për t'u integruar më tej në raportet në nivel njësie kryesore. Në këto raporte gjenden të analizuar statistika të studentëve të regjistruar për çdo vit, të diplomuar për çdo vit, të çregjistruar, aktiviteti kërkimor i personelit akademik, përmirësimi i infrastrukturës, ngarkesa mësimore e personelit akademik, përqindja e kalueshmërisë dhe përqindja e të diplomuarve, të dhëna nga raportet e Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës lidhur me pyetësorët e studentëve etj. Ky vlerësim bën pjesë në vlerësimin e përgjithshëm të performancës së çdonjërit prej personelit akademik të departamentit.

(E.1.7. - Raporti analizes vjetor i departamentit 2020-2021)

(E.3.4.- NJSBC dhe Karriera, Raporti vjetor 2020-2021)

Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

Të gjitha këto raporte të analizave vjetore në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe raporti i NJSBC paraqesin përveç rezultateve të pritshme, edhe adresime të mangësive të ndryshme për përmirësimin e cilësisë. Raportet gjenden të publikuara edhe në faqen web të FHF.

Si një element shumë i rëndësishëm i përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, kryhet dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik që bazohet tek Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, miratuar nga Senati Akademik dhe ku parashikohen të qarta parimet, procedurat, kriteret, periudhat e vlerësimit. Njëkohësisht, ky proces kryhet edhe për personelin ndihmës akademik që bazohet në Manualin "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës"

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” të miratuar nga Senati Akademik. (E.3.1, neni33; E.3.4; E.6.1; E.6.2)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UT, FHF. NJSBC-ja realizon vlerësim periodik në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit. NJSBC përmes hartimit të një raporti vjetor që përfshin informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, cilësinë e shërbimeve të ofruara për studentët, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë, ofron informacione të rëndësishme lidhur me vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. (E.1.1, neni 141; E.3.1, neni 26; E.3.4)</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Përvoja e fundit e fituar nga UT gjatë hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm në 2018 në kuadër të akreditimit, ka shërbyer si një përvojë pozitive edhe për metodikën e punës por edhe për të formalizuar gjithë instrumentet e posaçme për vlerësimin e programit të studimit: Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, Rregullorja “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës si dhe njësi kryesore për mbikëqyrjen e këtij procesi: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës në rang universiteti dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës në rang fakulteti. (E.1.7; E.3.1; E.3.2; E.3.4; E.6.2); (Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27.10.2018)</p>

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

GVJ konstaton se institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta. Në morinë e metodave për procesin e vlerësimit si: vlerësimi cilësor i mësimdhënies, metodologjisë së përdorur të mësimdhënies, kurrikulës, rezultateve të të nxënit; testet, etj., UT përfshin të dhënat e raporteve semestrale, siç janë % e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Gjithashtu pjesë të këtyre metodave të vlerësimit lidhen me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, të kurrikulës, syllabus-eve, provimeve. (E.1.7; E.3.2; E.3.4; E.3.5; E.3.6).

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.

GVJ konstaton se institucioni, nëpërmjet NJSBC-së përdoren edhe metoda të tërthorta vlerësimi, si: Pyetësorë të ndryshëm dhe vlerësime të studentëve sipas formateve të përcaktuara në Paketën e Instrumenteve të Cilësisë UT dhe Raporti i vetëvlerësimit nga stafi akademik. Departamenti i Historisë zhvillon anketime/pyetësorë me studentët, duke ruajtur anonimatit me qëllim vlerësimin e cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të studentëve. Pyetësorët shërbejnë edhe për të marrë mendimin e studentëve për programin përkatës të studimit Bachelor në Histori që ata ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij. Të dhënat e përpunuara i paraqiten departamentit të historisë nga NJSBC për vlerësim dhe analizë të mëtejshme. (E.1.7; E.3.2; E.3.4; E.3.5; E.3.6).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet			
	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 68

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në gjithë dokumentet zyrtare të tij, UT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Një nga aktorët e rëndësishëm të brendshëm janë studentët, të cilëve ju garantohet edhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës apo angazhohen edhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësime institucionale dhe të programit të studimit. Në dokumentet zyrtare si Statuti dhe rregullore të tjera institucionale, UT ka të sanksionuar një politikë dhe procedurë të brendshme të përcaktuar qartë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit. (E. 1.1, neni 141; E.3.1, Kreu III)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Siç rezultoi nga evidencat e vëna në dispozicion për vlerësimin e jashtëm si dhe nga verifikimet gjatë vizitës, përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë dhe njësia kryesore me strukturat e saj. Roli i tyre është i mirë përcaktuar në aktet rregullatore institucionale në kuadër të përmirësimit të vazhduar të cilësisë në UT. FHF ka përfaqësuesit e saj në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, kurse Departamenti ka përfaqësuesit e tij në Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës. (E.3.1, Kreu III, nenet 23-28;</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në respekt të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Të gjithë pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike janë të tilla që ruajnë anonimatit dhe konfidencialitetin e tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe</p>	<p>Nga evidentimi i bërë, rezulton që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet Panairi i Karrierës të organizuara nga UT/FHF ku marrin pjesë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 69

bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	subjekte publike dhe private. Gjithashtu është organizuar dhe “Java e Europës në Universitetin e Tiranës”. Gjithashtu mobilitetet Erasmus/+ kanë ndihmuar në këtë proces.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga UT/FHF janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. UT ka krijuar programin e transparencës e cila është publike ne faqen web te tij https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2 . Në faqet web të FHF dhe UT bëhen publike Analiza e Pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë. Edhe njësia bazë, në faqen e vet bën publike dokumentacionet bazë që lidhen me këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë UT-ja dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit, i cili bëhet në përputhje me format e miratuara nga Senati Akademik i UT-së. UT-ja garanton se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë është i përshtatshëm për qëllimin që ka, është i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet me një gjuhë të kuptueshme për të gjithë. (E.3.1, neni 32).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e	Nga vizita në institucion, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se në fund të vitit akademik, Departamenti harton raportin vjetor, me të gjithë komponentët e rezultateve të arritura vjetore, dhe mbi bazën e së cilës bëhet një analizë e ecurinë së tij dhe programeve që ofron, me

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 70

mangësive e dobësive të evidentuara.	synim përmirësimit e mangësive dhe problemeve të vërejtura. (E.1.7; E.3.1).			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton një vullnet të qartë nga ana e UT-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur GVJ konstaton se UT kryen një komunikim i vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit. Në mënyrë periodike janë organizuar disa veprimtari me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Me GVB-të të njësive të UT-së organizohen trajnime, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës për informimin e këtyre grupeve të vlerësimit, në lidhje me rëndësinë e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit. Gjithashtu KPSSC mund të formojë grupe te vogla pune për të dhënë ekspertizë, këshilla ose për të tërhequr mendime për çështje të sigurimit të cilësisë (E.3.1, neni 16/2).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Program studimi në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe atë kombëtar dhe nevojave të tregut të punës;
2. Angazhimi nga Departamenti i Historisë i një personeli akademik të kualifikuar dhe të qëndrueshëm në vite, garanton një cilësi të mirë të procesit të mësimdhënies/nxënies;
3. Një propagandë e përshtatshme për t’u bërë të ditur të interesuarve se programi i studimit “Bachelor në Histori” mundëson ndjekjen e studimeve të nivelit të dytë, si dhe në fusha të tjera që lidhen me shkencat historike;
4. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë përfaqëson njësinë kryesore me eksperiencën më të gjatë në Shqipëri, kontributin me të rëndësishëm në përgatitjen e specialisteve në fushën e historisë dhe reputacionin me të mirë në tregun e punës;
5. Përmirësimi i infrastrukturës mësimore shkencore rrjedhë e investimeve gjatë viteve të fundit garantojnë zhvillimin me efikasitet të këtij programi;

b. Pika të dobëta:

1. Mosmbajta e të dhënave të studentëve nga sekretaria mësimore, në koherencë me aktet nënligjore në fuqi; (*Standardi IV.5, kriteri 1*)
2. Rënia e numrit të studentëve për ndjekjen e programit të studimit, duke preferuar fusha/disiplina të tjera;

Rekomandime:

1. Sekretaria mësimore të punojë në koherencë me udhëzimet, lidhur me risitë e mbajtjes së të dhënave të studentëve nga hyrja deri në dalje;
2. Fakulteti të rrisë promovimin rreth këtij programi studimi, nëpërmjet një fushate informuese dhe sensibilizuese, për afrimin e studentëve në këtë program;
3. Të përditësohet gradualisht programi i studimit “Bachelor në Histori”, duke synuar ekuivalentimin ose përafrimin e programit mësimor me programe të ngjashme të huaja;

Conclusions of the external evaluation of the first cycle study program "Bachelor in History"

a. Strengths and Affirmations:

1. Study program in accordance with the development strategy of the institution and the national one and the needs of the labor market;
2. The commitment by the Department of History of a qualified and stable academic staff over the years, guarantees a good quality of the teaching/learning process;
3. An appropriate propaganda to let interested parties know that the "Bachelor in History" study program enables the pursuit of second-level studies, as well as in other fields related to historical sciences;
4. The Faculty of History and Philology represents the main unit with the longest experience in Albania, the most important contribution to the preparation of specialists in the field of history and the best reputation in the labor market;
5. The improvement of the scientific teaching infrastructure and the investments during the last years guarantee the efficient development of this program;

b. Weak points:

1. Non-maintenance of student data by the teaching secretariat, in coherence with the by-laws in force; (*Standard IV.5, criterion 1*)
2. The decrease in the number of students following the study program, preferring other fields/disciplines;

Recommendations:

1. The teaching secretariat should work in coherence with the instructions, related to the innovations of keeping student data from entry to exit;
2. The Faculty should increase the promotion of this study program, through an information and awareness campaign, to bring students closer to this program;
3. To gradually update the "Bachelor in History" study program, aiming at the equivalence or alignment of the curriculum with similar foreign programs;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushet n pjesërisht	Përmbushet n kryesisht	Përmbushet n plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

